

RAPORT


I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Bachelor në “Shkenca Komunikimi”

Kolegji Universitar “BEDER”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Dr. Arben MUKA



Dr. Diana KALAJA



Prill 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSC në Shkenca Komunikimi

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "Bedër"
2	Departamenti përgjegjës/ Fakulteti që e ofron	Departamenti i Shkencave të Komunikimit Fakulteti i Shkencave Humane
3	VKA/Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKA Nr. 159 datë 25.03.2011 Licencuar me VKM Nr. 286, datë 06.04.2011 Leja e ushtrimit të aktivitetit akademik me Urdhër të MASH nr. 534, datë 27.10.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	VKA Nr. 469, datë 03.05.2013 (Pozitiv, me rekomandime); Akreditimi i parë: Urdhër i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës Nr. 223, datë 04.06.2013
5	Plotësimi i rekomandimeve	Shkresë nr. 72/1 Prot., datë 04.11.2013
6	Regjistrimi i formës së Diplomës	Me Urdhër të MAS Nr. 61, datë 09.02.2016, ndryshuar me Urdhër të MAS Nr. 420, datë 20.09.2017
7	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "Shkenca Komunikimi"
8	Cikli i studimit:	Cikli I
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 Kredite (ECTS)
11	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjeshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	PO
14	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
15	Diplomë e përbashkët /Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
17	Numri i studentëve	75 studentë (regjistruar tre vitet e fundit)

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e ASCAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit "Bachelor në Shkenca Komunikimi", Kolegji Universitar BEDER

Programi "Bachelor në Shkenca Komunikimi" i Kolegjit Universitar BEDER është licencuar me Vendimin VKM nr. 286 datë 06.04.2011. Programi i studimit është vlerësuar në kuadër të akreditimit të parë dhe me Vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 469, datë 03.05.2013 dhe Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 223, datë 04.06.2013 është akredituar Pozitiv, me rekomandime.

Ky Raport i Vlerësimit të jashtëm është hartuar në kuadër të akreditimit periodik.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- Dr. Arben Muka
- Dr. Diana Kalaja

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL /Bordi i Akreditimit. Menaxheri teknik (MT) i ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure është specialisti i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Më datë 19.03.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 6/33 Prot., datë 19.03.2019 "Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm", Kolegji Universitar "BEDER" është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 25.03.2019, Kolegji Universitar "BEDER" përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 85/4 Prot., datë 25.03.2019 "Komente rreth draft raportit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Bsc në "Shkenca Komunikimi".

Në këtë dokument institucioni ka bërë komente për Draft-RVJ. Pasi shqyrtoi komentet e KUB, grupi i vlerësimit të jashtëm arriti në përfundimin sa më poshtë vijon:

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka shqyrtuar komentet e KUB mbi draftraportin, sipas shkresës datë 25.03.2019, nr prot. 85/4, duke iu rikthyer edhe një herë dokumentacionit të grumbulluar mbi këtë aspekt.

Nisur nga shpjegimet që janë bërë në raportin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit që është në fokus, por dhe nga bashkëbisedimi me studentët, stafin akademik, drejtuesit e Departamentit dhe nga vizita dhe marrja e informacionit në mjediset e bibliotekës së KUB – u evidentua se për fushën e shkencave të komunikimit dhe gazetarisë ka tekste bazë në funksion të kurrikulës. Ato ishin të siguruara nga kooperimi me subjekte dhe institucione që menaxhojnë publikimin e tyre në gjuhën shqipe, apo që i sigurojnë në versionin origjinal. Bazuar në syllabus-et që përgatitin pedagogët në programin e studimit të nivelit të parë "Shkenca Komunikimi", pjesa dërmuese e titujve të rekomanduar ishin pjesë e fondit të Bibliotekës në KUB.

Duke e konsideruar pasurimin e fondit bibliotekar si një proces të pandërprerë me literaturën e nevojshme për procesin mësimor, si dhe parë angazhimin konkret të Departamentit të Shkencave të Komunikimit në KUB, nga viti 2013 e deri në ditët e sotme, grupi i vlerësimit të jashtëm reflekton, duke e konsideruar rekomandimin "Të sigurohen tekste bazë në disa disiplina", si të plotësuar.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit në akreditimin e parë


- a) Të qenurit një institucion i ri, sjell mungesën e përvojës dhe të traditës të cilat i japin departamentit dhe programit mësimor një qëndrueshmëri dhe besueshmëri;
- b) Të rritet numri i personelit akademik efektiv;
- c) Të përshtatet fusha e studimit të personelit akademik me disiplinën përkatëse;
- d) Të përmirësohet programi i disiplinës Gjuhë Shqipe 1 dhe 2;
- e) Të sigurohen tekste bazë në disa disiplina;
- f) Të rritet numri i titujve dhe botimeve bashkëkohore në bibliotekën e Institucionit;
- g) Të realizohet një raport financiar për këtë program studimi.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin “Të qenurit një institucion i ri, sjell mungesën e përvojës dhe të traditës të cilat i japin departamentit dhe programit mësimor një qëndrueshmëri dhe besueshmëri” gjatë vizitës dhe takimeve u vu re se Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka përfshirë në grupin e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm emra të njohur nga fusha e gazetarisë në vend, kryeredaktorë të televizioneve kombëtare, ekspertë dhe analistë të shtypit të shkruar. Kjo ka sjellë krijimin e një ambienti me standardet profesionale. Studentët kryejnë praktikën dhe internship në mediat më të njohura në vend. Gjithashtu Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi me pedagogë të jashtëm dhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, dhe ka plotësuar në këtë mënyrë nevojat për studentët e këtij Programi Studimi, duke u bërë një qendër dinamike që reflekton zhvillimet në tregun mediatik në vend dhe më gjerë. Rekomandim i plotësuar
- b) Për rekomandimin “Të rritet numri i personelit akademik efektiv”, u vëzhgua se KUB ka rritur numrin e pedagogëve në Departament. Ndër vite personeli i departamentit është plotësuar me pedagogë. Një tjetër personel efektiv ishte shtuar me fillimin e vitit mësimor 2018-2019. Rekrutimi është bazuar në procedurat përkatëse. Departamenti planifikon të zgjerohet me personel të ri. Për lëndë specifike janë përzgjedhur edhe forma bashkëpunimi me lektorë me kontratë. Kjo pasi vete natyra e shkencave të komunikimit kërkon edhe bashkëpunim me zëra të njohur të medias. Rekomandim i plotësuar.
- c) Për rekomandimin “Të përshtatet fusha e studimit të personelit akademik me disiplinën përkatëse”, Departamenti ka bërë një shpërndarje të lëndëve mësimore tek pedagogët në vartësi të specialitetit të tyre. Kjo është e lidhur edhe me afrimet e reja të pedagogëve efektivë në Departament dhe në Kolegjin Universitar BEDER. Rekomandim i plotësuar
- d) Për rekomandimin “Të përmirësohet programi i disiplinës Gjuhë Shqipe 1 dhe 2”, Departamenti ka punuar dhe rishikuar syllabuset e lëndëve. “Gjuhë Shqipe 1 dhe 2” janë lëndë që shërbejnë si bazë e njohurive për gazetarët, por duke parë zhvillimet e sistemit arsimor parauniversitar, këto lëndë janë përshtatur për degën e shkencave të komunikimit. Çdo fillim viti mësimor, Departamenti bën ëorkshope për rishikimin e programit të lëndëve. Gjithashtu Departamenti ka një Komitet Teknik i cili orienton për lëndë dhe syllabuse. Rekomandim i plotësuar.
- e) Për rekomandimin “Të sigurohen tekste bazë në disa disiplina”, Departamenti i Shkencave të Komunikimit bashkëpunon me Institutin Shqiptar të Medias si edhe merr tekste bazë ndërkombëtare që janë përkthime të teksteve kryesore të gazetarisë. Fashikuj të veçantë përdoren edhe në lëndët praktike të gazetarisë. Për tekstet e nevojshme për programin “Bachelor” dhe “Master”, në Shkencat e Komunikimit pranë bibliotekës së Kolegjit Universitar BEDER është një listë e gjerë me tituj botimesh

të cilët mund të shfrytëzohen nga studentët. Departamenti duhet ta vadojë më tej punën në këtë drejtim. Rekomandim i plotësuar.

- f) Rekomandimi “Të rritet numri i titujve dhe botimeve bashkëkohore në bibliotekën e Institucionit”, është plotësuar. Në bibliotekë është shtuar numri i titujve si në gjuhën shqipe, anglisht, turqisht. Një pjesë e mirë janë tituj bashkëkohor. Gjithashtu Biblioteka ka edhe formatin online të kërkimit të librave. Gjatë dy viteve të kaluara studentët u përfshinë në një nismë “Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët”, tillë ishte dhe fushata e studentëve të programit “Master”, për pasurimin me libra të Bibliotekës së Universitetit. Si pasojë e saj bibliotekës së KUB iu shtuan rreth 10,000 libra të rinj. Po kështu, Ambasada Amerikane në Tiranë, gjatë muajit tetor 2018, ka dhuruar mbi 3000 libra të rinj. Pjesa më e madhe e tyre, rreth 2018 libra ishin botime specifike për Departamentin e Shkencave të Komunikimit.
- g) Rekomandimi “Të realizohet një raport financiar për këtë program studimi”, është zbatuar në kuadër të kolegjit Universitar. Sikurse e përmbajnë edhe procedurat në bazë të legjislacionit aktual, raporti financiar realizohet për të gjithë Kolegjin Universitar BEDER ku është i përfshirë edhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe programet e studimit, si atë në nivel “Bachelor”, ashtu dhe atë në nivel “Master i shkencave”. Rekomandim i plotësuar në kuadër të Kolegjit KUB.



ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit si pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane ka për mision përgatitjen e individëve të kualifikuar në fushën e gazetarisë, të komunikimit, të marrëdhënieve publike dhe në fusha të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale dhe mbështetjen shkencore-kërkimore, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe të projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe ndjekin zhvillimet bashkëkohore në fushën e komunikimit, medias e të mbarë shoqërisë.

Në vizionin e tij Departamenti i Shkencave të Komunikimit synon të përgatisë profesionistë të aftë për tregun e punës në kushtet e një shoqërie globale dhe zhvillimi të shpejtë të teknologjive moderne që kanë përfshirë fushën e komunikimit dhe të medias. Departamenti synon të bëjë një ndërthurje të aftësimit teorik dhe praktik të studentëve.

Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në njëllojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.

Programi i studimit "Bachelor" në profilin Shkenca Komunikimi është projektuar t'u ofrojë studentëve një formim intelektual, profesional e të gjithanshëm, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektive në fushën e komunikimit, marrëdhënieve me publikun e të medias.

Nëpërmjet faqeve online dhe sistemeve të brendshme të Teknologjisë së Informacionit stafi akademik, administrativ dhe studentët kanë mundësinë e transparencës mbi programet, projektet si edhe dokumentacionin e përkatës të programit mësimor.

Misioni dhe Objektivat e programit të studimit "Bachelor" në profilin Shkenca Komunikimi janë të përcaktuara qartë dhe përshtaten me Objektivat dhe strategjinë e KUB

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Programi i Studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi synon të përgatisë: Specialistë dhe profesionistë të shkencave të komunikimit, të kualifikuar në fushën e gazetarisë, të komunikimit dhe të marrëdhënieve publike dhe në fusha të ngjashme me to, të aftë për tregun e punës në kushtet e një shoqërie globale dhe të shpejtë të teknologjive moderne që kanë përfshirë fushën e komunikimit e të medias. Në programin e studimit janë pjesë si lëndët bazë të formimit teorik, lëndët e profilit si edhe praktikat profesionale. Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi ka objektiva në formimin profesional. Programi i studimit është në përshtatje me nevojat e tregut të punës. Departamenti ka ndërtuar një studim tërësor të tregut i cili detajon situatën aktuale të medias dhe drejtimet e mundshme të evoluimit të tregut mediatic në vend.
Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	

	<p>Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi në KUB reflekton zhvillimet në tregun medias, sidomos mediave të reja në vend, periudhën e kalimit nga transmetimet analoge në dixhitale, rritjen dhe fuqizimin e zyrave të marrëdhënieve me publikun si në institucionet publike dhe private.</p> <p>Aktualisht Departamenti është në proces pune për të përshtatur disa nga lëndët e Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi në një format më të ri, për të zëvendësuar disa nga lëndët ekzistuese, me lëndë të reja që i përshtaten më mirë nevojave aktuale të formimit profesional të gazetarëve të nevojshme edhe për tregun e punës.</p>
--	--

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen e njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit është përshtatur me zhvillim në planin strategjik që ka institucioni. Në hartimin e kurikulave dhe përshtatjen e tyre vit pas viti janë reflektuar eksperiencia që KUB ka formuar, dhe fakti që zëra të fuqishëm nga tregu mediatik në vend janë pedagogë në KUB. Programi përmban lëndë të grupeve teorike, formimit bazë dhe praktikave mësimore.</p> <p>Bashkimi me stafin e KUB edhe i gazetarëve të njohur në vend me leksione dhe workshop edhe në formate të ndryshme mësimdhënie përcaktohet edhe si një ndër drejtimet kryesore për zhvillimet strategjike të KUB dhe specifikisht Departamentit të Shkencave të Komunikimit.</p>
--	---

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi synon të realizojnë formimin e studenteve në përputhje me synimet strategjike duke plotësuar edhe nevojat e tregut të punës në vend.</p> <p>Institucioni ka realizuar me anën e një grupi pune të ngritur me personel të Departamentit të Shkencave të Komunikimit, një studim të tregut të punës. Studimi përfshin në mënyrë të detajuar mundësitë e punësimit të studentëve në tregun rajonal, kombëtar e ndërkombëtar, kërkesat e punëdhënësve; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra, numrin e kërkesave të maturantëve për këto programe. Studimi është pjesë e reformimit që do të bëjë për kurikulat dhe programet e reja mësimore të programit të studimit "Bachelor" në Shkenca Komunikimi dhe çelje të programeve të reja. (Evidenca nr. 44: Shkresë për dorëzimin e dosjes për riorganizim të programit të studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi dhe çelje të programeve të reja)</p>
---	--

Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi është një program i mbështetur në legjislacion në vend, ligjin për arsimin e lartë dhe rregulloret përkatëse të nxjerra nga Ministria e Arsimit dhe nuk</p>
--	--

bie ndesh me interes kombëtare.

Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi ndihmon në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Në kuadër të projekteve ekstrakurrikulare dhe klubeve studentore, në vitin akademik 2017-2018, klubi i leximit të studentëve ndërmori një projekt "Një libër më shumë për Preshevën". Ky projekt grumbulloi libra në gjuhën shqipe dhe mjeteve shkollore për fëmijët e luginës së Preshevës. Në maj 2018 librat u dorëzuan në Komonën e Bujanocit nga një grup me përfaqësues nga studentët dhe pedagogë nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe KUB.

Konkluzionet e vlerësimit:

Objektivat e Programit Bachelor në Shkenca Komunikimi janë në përputhje me misionin e KUB dhe plotësojnë standartet.

Programi, i ndërtuar si studime të ciklit të parë, u jep njohuri të kompletuara studentëve për një përgatitje sa më të plotë profesionale në Shkencat e Komunikimit, Gazetari, Komunikim, Marrëdhënie Publike. Departamenti mbështet mirë misionin e tij për të përgatitur profesionistë të aftë në respektimin e deontologjisë dhe etikës profesionale. Programi ofron mundësinë që studentët të pajisen me njohuritë për të bërë një analizë të thelluar e shkencore të fakteve dhe të situatave të ndryshme, në raportimin e përcjelljen e një informacioni të saktë, në përfitimin nga studentët të një kulture të gjerë pluraliste, bashkëkohore mbi mënyrën e mendimit dhe konceptimit të situatave dhe ngjarjeve.

Programi i studimit ka objektiva të mirëformatuar dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të KUB, si dhe me kërkesat e tregut të punës për specialistë në këtë fushë. Programi është ndërtuar dhe përmirësohet vazhdimisht në përputhje me misionin e Institucionit dhe objektivat kryesore të tij. Objektivat e programit përcaktohen qartë dhe përfshijnë dijet teorike, aftësitë dhe kompetencat praktike profesionale në realizmin e punës së specialistit të marrëdhënieve me publikun.

Informacioni i nevojshëm për të ndryshuar dhe përsosur më tej programin Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi merret nga disa forma si nga anketimet që bëhen me studentët, informacioni nga lektorët e ftuar që janë edhe gazetarë aktivë të njohur në vend, vlerësimet e stafit akademik nga studentet përmes anketimeve online. Harmonizimi i informacionit të marrë si nga brenda edhe nga jashtë për nevojat kombëtare për zhvillim luan një rol të rëndësishëm në përditësimin e programeve akademike. Departamenti ka në proces përmirësime të programit të studimit dhe ndryshim të dy lëndëve për ta lidhur më shumë programin Bachelor në Shkenca Komunikimi me aspekte praktike të punës si gazetar apo PR apo specialist i komunikimit.

2. Struktura akademike e Fakultetit/Departamentit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave Humane në Kolegjin Universitar BEDER ka në përbërjen e tij këto departamente:

- (i) Departamenti i Shkencave Islame;
- (ii) Departamenti i Drejtësisë;
- (iii) Departamenti i Shkencave të Komunikimit.

Secili nga departamentet ka stafin e tij akademik, një punonjës të personelit ndihmës akademik dhe një kordinatorë të departamentit. Tabelat e plotë gjenden në anekset në fund të këtij raporti

Dekanati i Fakultetit të Shkencave Humane të KUB është organi i lartë ekzekutiv dhe ka në përbërje (i) Dekanin; (ii) Zëvendësdekanin; (iii) Përgjegjës të njësive bazë (departamenteve); (iv) administratorin e fakultetit;

Edhe Dekanati i Fakultetit vepron mbi bazën e rregulloreve të përcaktuara dhe të miratuara. Dekanati mbledhet jo më pak se një herë në muaj. Dekani ka titullin Profesor dhe ka një listë funksionesh / detyrash të përcaktuara.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka programe studimi të nivelit të parë dhe të dytë:

- Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor në shkenca Komunikimi)
- Cikli i Dytë i Studimeve (Master i Shkencave me profilet "Gazetari" dhe "Marrëdhënie publike" në Shkenca Komunikimi)

Secili nga Departamentet ka një mision të përcaktuar dhe rregulloret përkatëse. Fakulteti ka rregullore të mirëpërcaktuara për funksionet e tij duke patur të veçante si "Rregulloren mbi organizimin akademik" ashtu edhe "Rregulloren mbi organizimin administrativ"

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit (Tabelat 2, në Aneks).

Sikurse shihet edhe nga tabelat 2 (2.1-2.5) personeli akademik si ai efektiv ashtu edhe ai me kontratë janë pak a shumë në raporte të ngjashme midis departamenteve të ndryshme në Fakultetin e Shkencave Humane. Ndër vite numri i PAE për të tre departamentet ka qenë i ngjashëm me diferencë fare të vogla. Dhe këto raporte kanë mbetur të tilla përgjatë gjashtë viteve. Diferenca midis departamenteve është në numrin e PAK. Departamenti i Drejtësisë është gjithnjë me numër më të madh pedagogësh me kontratë. Kjo shpjegohet edhe me faktin se disa nga këta pedagogë japin lëndë specifike edhe në programet mësimore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Po kështu në mënyrë proporcionale është edhe raporti i titujve shkencorë dhe gradave midis 3 departamenteve të Fakultetit.

- Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Shkencave të Komunikimit është njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit "Bachelor në Shkenca Komunikimi". Departamenti e ka këtë përgjegjësi të përcaktuar nga Statuti. Në mënyrë periodike Departamenti organizon mbledhje për mbarëvajtjen e programit mësimor. Si njësi bazë, Departamenti organizon dhe më pas miraton edhe syllabuset e lëndëve dhe diskuton dhe literaturën e cila duhet të shoqërojë lëndët.

Drejtuesi i departamentit është në dijeni dhe komunikon me secilin nga pedagogët në mënyrë individuale edhe për anketimet/vlerësimet e secilit pedagog për punën e tij, vlerësimet këto që bëhen nga studentët.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka në përbërje të tij 11 anëtarë: Përgjegjësi i departamentit ka gradën Dr.; një pedagog ka gradën Doc. Dr; dy pedagogë janë me gradën Dr; pesë pedagogë janë me kualifikimin Msc (dy në proces Doktorate). Dy anëtarë të stafit janë personel akademik ndihmës dhe kordinatorja.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e

Personeli akademik dhe ai administrativ i cili jep mësim në programin “Bachelor në Shkenca Komunikimi”, sikurse i gjithë personeli i KUB, i rregullon marrëdhëniet e marrëdhëniet e punës mbi kontrata si me Kohë të Plotë dhe me Kohë të Pjesëshme, me afat apo pa afat, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, Kodit të Punës si edhe rregulloreve të KUB. Pjesa më e madhe e pedagogëve në programin Bachelor në Shkenca Komunikimit janë pedagogë të Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Në disa nga lëndët me zgjedhje dhe në disiplinat e ngjashme dhe / ose integruese të grupit D janë pedagogë PAK nga Departamentet e tjera (2 pedagogë nga Departamenti i Drejtësisë dhe 1 nga Departamenti i Shkencave Islame për vitin mësimor aktual). Gjithashtu në program japin mësim edhe disa pedagogë me kontratë PAK të cilët janë nga emrat e njohur të profesionistëve të gazetarisë dhe të cilët janë disa nga disiplinat e formimit karakterizues. (Reference tabelat 11 dhe tabela 13) Përfshirja e pedagogëve si efektiv me kontratë të plotë apo të pjesëshme, ndiqte një proces të përcaktuar rekrutimi, ku shikoheshin të gjithë elementët, si ata të gradave shkencore, diplomat, aktiviteti kërkimor, përvoja dhe kriteret e tjera të përcaktuara me ligj. Kriteret dhe hapja e vendeve të reja të punës publikohej edhe në faqen online të KUB. Departamenti ka rol kryesor në përcaktimin e pedagogëve për programin specifik të studimit

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat 4.1 - 4.6 në Aneks)

Sipas të dhënave të pasqyruara në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe nga vizita në institucion numri i personelit akademik me tituj dhe grada përputhet me rregulloret e programit dhe të Kolegjit Universitar BEDER.

Personeli Akademik Efektiv (si numër fizik personeli) në programin e ciklit të parë ka ardhur duke u rritur dhe duke marrë më shumë ngarkesë mësimore nga viti në vit. Nga më pak se 39% në fillim, ai është rritur në 86% në vitin mësimor 2016-2017. Aktualisht ky raport është në nivelin rreth 68% në vitin 2018-2019. (Referuar Tabelave 4 në aneks)

Duke krahasuar raportet e ngarkesës mësimore për lëndët e mbuluara nga Personeli Akademik Efektiv të punësuar me kontratë të plotë ndaj personelit akademik total të angazhuar në realizimin e programeve në ciklin e parë, ky raport është ka qenë gjithnjë mbi 70% dhe për vitet mësimore 2016 - 2017, 2017- 2018 dhe 2018-2019 është mbi 80% (respektivisht 88%, 87% dhe aktualisht 81%). (Referencë Tabelat Nr. 13, në aneks)

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelat 5 në Aneks)

Nga viti në vit, ka ardhur duke u rritur numri i PAE me tituj. Raporti i personelit PAE/PAK për titujt /gradat, për 6 vitet mësimore të marra në shqyrtim duke nisur nga 2013-2014 deri në vitin aktual është 3/12, 4/6, 5/7, 5/2, 3/3 dhe 4/3. Raportet shprehin ritmin e rritur të marrjes së titujve/gradave për personelin akademik efektiv.

Në tabelën 5 gjendet të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet mes tyre. Kolegjit Universitar BEDER bën përpjekje për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Kjo shikohet edhe nga mbledhjet që bëhen si edhe lista e përditësuar e trajnimeve të organizuara në 2014-2018. (Sipas dokumenteve të vlerësimit të brendshëm dhe tabela 22 në anekse për projektet e veçanta kërkimore sipas anëtareve të stafit).

Në se në fillim të programit, vitit shkollor 203-2014 raporti PAE/PAK ishte mjaft në disfavor të PAE për secilën nga titujt (ishte 1/4 për Prof. As., 1/2 për Dr., dhe 5/8 për Dr. në proces) në vitin mësimor 2018-2019 ky raport është përmirësuar në favor të PAE (1/1 për Prof. As., 6/2 për Dr., dhe 1/0 për Dr. në proces dhe 7/4 për asistentë me Msc.)

Të dhënat sipas seksit (Tabela 4/6 në Aneks)

Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe veçanërisht programi i studimit është i balancuar nga kriteri i gjinisë dhe nga viti në vit ka ardhur duke u rritur numri i pedagogeve femra në departament.

Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabelat 6 në Aneks)

Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka krijuar një bashkërendim të brezave të ndryshëm gjatë procesit mësimdhënës. Kjo i jep mundësi studentëve të marrin përvojave të ndryshme në lëndë dhe praktika të ndryshme. Janë 6 pedagogë që i përkasin grup moshës 25-35 vjeç, 11 pedagogë të grup moshës 36-45 vjeç, 5 pedagogë që i përkasin grup moshës 46-55 vjeç, dhe 1 pedagog i grup moshës 66-68 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Zyra e Burimeve Njerëzore është e njehsuar për të gjithë KUB. Zyra e Burimeve Njerëzore ka kontratat individuale të secilit nga anëtarët e stafit. Ata janë të njohur me detyrat dhe të drejtat e tyre sipas kontratave respektive. Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore në KUB u shikuan, me metodën e sondimit, kontratat e stafit akademik dhe mbështetës. Kontrata e punës kishte edhe një aneks të kontratës në të cilin përcaktoheshin specifikimet e pozicionit të punës. Zyra e Burimeve Njerëzore në KUB kishte dosjet me kontratat dhe elementët e tjerë të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për secilin nga anëtarët e Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Kontratat kishin të detajuar si pjesën mësimore, ashtu edhe elementet e tjerë të punës që konvertoheshin si elementë të pagës dhe ngarkesës së punës.

Kontratat janë të firmosura nga pedagogu përkatës dhe punëdhënësi. Kontrata ka edhe një aneks kontratë në të cilën përcaktohet vendi i punës pozicioni, të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit.

Cilësia e stafit ndihmës/administrativ për çdo njësi bazë

Departamenti i Shkencave të Komunikimit, si pjesë e strukturës organizative të Kolegjit Universitar BEDER, KUB, ka personelin akademik që kryen procesin e mësimdhënies së bashku me veprimtaritë e lidhura me të, personelin administrativ dhe ndihmës.

Personeli administrativ dhe mbështetës, është një pjesë e përbashkët për të gjithë Kolegjin KUB dhe ndërsa sekretare/koordinatore dhe një person tjetër janë të dedikuar në departament. Personeli që është për të gjithë universitetin përfshin zyra të tilla si Burimet Njerëzore, Sekretaria, Biblioteka, zyra e Financës etj.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion: Gjatë vizitës në institucion u kërkua lista e plotë e stafit aktual për programin e studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi dhe lëndët përkatëse që ata japin si edhe përshkrimin që janë me kohë të plotë apo të pjesëshme. Raportet janë në përshtatje me kërkesat e legjislacionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Departamenti i Shkencave të Komunikimit, si pjesë e KUB, ndjek procedura dhe aktet ligjore në rekrutimin e personelit në përputhje me (i) Statutin e KUB, (ii) Rregulloren themelore të KUB; (iii) Procedurën e punësimit të personelit. Procesi përzgjedhës për rekrutimin e personeli përfshin aplikimin individual për pozicionet e njoftuara dhe konkursin përzgjedhës.
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.

Sipas statutit të KUB kriteret profesionale të punësimit përcaktohen nga njësia bazë, në këtë rast departamenti. Këto aprovohen nga Dekani dhe Rektori i KUB. Për përzgjedhjen e kandidatëve që do të jenë pedagogë ngrihet një komision i posaçëm me përbërje shumica nga departamenti i cili bën propozimet dhe listimin e aplikantëve të cilin ja përcjell Rektorit për vendimmarrje.

Pedagoget që japin mësim në programin “Bachelor në Shkenca Komunikimi” në departament janë të punësuar me kontratë si Personel Akademik Efektiv në KUB (PAE) dhe si Personel Akademik me Kontratë.

Duke krahasuar raportet e ngarkesës mësimore për lëndët e mbuluara nga Personeli Akademik Efektiv të punësuar me kontratë të plotë ndaj personelit akademik total të angazhuar në realizimin e programeve në ciklin e parë, ky raport është ka qenë gjithnjë mbi 70 % dhe për vitet mësimore 2016- 2017, 2017- 2018 dhe 2018-2019 është mbi 80% (respektivisht 88%, 87% dhe aktualisht 81 %). (Referencë Tabelat Nr. 13, në aneks)

Personeli Akademik Efektiv (si numër fizik personeli) në programin e ciklit të parë ka ardhur duke u rritur dhe duke marrë më shumë ngarkesë mësimore nga viti në vit. Nga më pak se 39% në fillim, ai është rritur në 86 % në vitin mësimor 2016-2017.

Aktualisht ky raport është në nivelin rreth 68% në vitin 2018-2019. (Referuar Tabelave 4 në aneks)

Vlerësimi i pedagogëve kryhet në disa nivele:

- nga drejtuesi i drejtpërdrejtë në këtë rast ai i Departamenti të Shkencave të Komunikimit;
- në fund të çdo semestri gjatë vitit akademik bëhet vlerësimi nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. Vlerësimet janë individuale dhe pedagoget njohin vetëm vlerësimet e tyre dhe jo të pedagogëve të tjerë duke ruajtur kështu të drejtën e privatësisë.

Zyra e Burimeve Njerëzore mban bazën e të dhënave të raporteve të vlerësimit, rekrutimit të personelit, intervistat e kandidatëve, njoftimeve për vende vakante, etj. Njoftimet janë të postuara edhe në faqen web të institucionit.

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;

Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;

Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të

Departamenti i Shkencave të Komunikimit si pjesë e strukturës organizative të Kolegjit Universitar BEDER ka të evidentuar ngarkesën mësimore, profilin dhe fushat e tyre kryesore të ekspertizës, eksperiencat e veçanta dhe profilet akademike.

Gjithashtu edhe zyra e Burimeve Njerëzore në KUB ka dosje të veçanta për çdo pedagog duke krijuar një bazë të rëndësishme të dhënash. Në këtë zyrë mbahen edhe kontratat e lidhura me stafin vit pas vit (në rastet e ndryshimeve dhe kontratave me afat). Në

<p>parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor,, ose titullin akademik "Docent,,</p>	<p>faqen në Internet të KUB publikohen kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p> <p>Titullarët e lëndëve janë të gjithë me gradën shkencore Dr. dhe asistent lektorët janë me kualifikim Doktorant dhe Msc.</p>
---	---

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

- Kriteri 1** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;
- Kriteri 2** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;
- Kriteri 3** Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).

Departamenti i Shkencave të Komunikimit, është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane në KUB. Ai ndan së bashku me departamentet e tjera në KUB personelin ndihmës mësimor – shkencor të tillë si bibliotekën, sekretariatë kryesore, zyrën e kërkimit shkencor dhe zyrën e projekteve.

I gjithë personeli i këtyre zyrave ndihmon studentët e programit të ciklit të parë për të realizuar detyrat, zhvillimin e rregullt të praktikave mësimore, marrjen e informacionit të nevojshëm dhe komunikimin efektiv në shërbim të procesit mësimor.

Institucioni ka ngritur një qendër praktike ku studentët bëjnë praktikë me mediat sociale dhe online të nevojshme për aftësimin profesional të tyre ne mediat e reja. Portali informativ www.objektiv.al është një mundësi e mirë që u shërben studenteve për praktikë profesionale.

Angazhimi i personelit akademik dhe ndihmës synon përmbushjen e objektivave të programeve të ciklit të parë. Kjo realizohet si me punën brenda institucionit, ashtu edhe në drejtim të bashkëpunimeve me institucione dhe kompani të ndryshme për të siguruar realizimin e praktikave profesionale nga studentët e departamentit.

Departamenti ofron për studentët edhe këshilltarë akademikë si një formë efektive për të orientuar studentët në përzgjedhjen e lëndëve në përputhje me programin e studimeve. Ata janë orientuesit e studentëve në faza të ndryshme gjatë zhvillimit të këtij programi studimesh

Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi ka të përfshirë si anën teorike të zhvilluar në ambientet e KUB ashtu edhe atë praktike. KUB ka Zyrën e Planifikimit të Karrierës, ku çdo fillim viti departamenti përcakton një përfaqësues të tij në këtë zyrë. Po kështu në programin mësimor është edhe lënda e Praktikës Profesionale, ku studentët ndahen në grupe nën drejtimin e disa pedagogëve dhe varësisht interesit të tyre zhvillojnë praktikë.

Raporti aktual pedagog/studentë në këtë lëndë është rreth 1 me 7.

Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

- Kriteri 1** Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;
- Kriteri 2** Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.

Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë dy pjesë shumë të rëndësishëm të strukturës organizative në KUB. Ato përgatisin plan lidhur me trajnimet e domosdoshme për personelit.

Trajnimet pasqyrohen edhe në faqen web tek NJSBC,

www.qac.beder.edu.al.

Temat e trajnimeve përcaktohen në bashkëpunim me Departamentin e Komunikimit (dhe njësitë e tjera të ndryshme sipas nevojave specifike). Zyra e Burimeve Njerëzore përmes një e-mail zyrtar njofton të gjithë anëtarët e personelit për të tematikat e trajnimeve dhe fton për pjesëmarrje.

KUB disponon bazë të dhënash për të gjitha programet e ofruara duke i mbajtur ato në dy forma, si atë të printuar ashtu edhe në formë dixhitale, të cilat përditësohen vazhdimisht.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në RVB, në konstatimet gjatë vizitave dhe diskutimeve me stafin akademik dhe studentët, vlerësojmë se standardet plotësohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret e brendshme të KUB. KUB ka një grup rregulloresh që udhëheqin veprimtarinë e stafit. Kjo siguron që procedurat të zbatohen dhe të ketë një menaxhim efektiv të tij. Departamenti në kuadër të KUB ka bërë përpjekje për rritje profesionale me pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe projekte të ndryshme. Edhe raportet me tituj dhe grada që stafi ka dhe ndryshimi pozitiv i tyre në rritje të vazhdueshme është tregues i kësaj.

Duke krahasuar CV e PAE për programin e studimit dhe lëndët që ata kanë program vihet re një përshtatje e mirë midis tyre. Kjo përshtatje për fushën e ekspertizës është shumë e mirë edhe për PAK të cilët janë nga emrat e njohur të gazetarisë dhe medias në vend. Ky është edhe një nga avantazhet pozitive të këtij programi studimi.

Po kështu edhe qëndrueshmëria e stafit është një tregues pozitiv i programit. Është një grup kryesor prej 7 pedagogësh (PAE) që nuk kanë ndryshuar thuajse që nga viti i parë i hapjes së programit. Thuajse e ngjashme është kjo qëndrueshmëri edhe tek PAK, me diferencën që nga viti në vit disa pedagogë të PAK kanë kaluar në PAE.

Komunikimi nëpërmjet sistemit të brendshëm online është një mekanizëm mjaft i mirë për të shpërndarë informacionin dhe për ta bërë atë sa më transparent.

Personeli administrativ është mbështetës i atij akademik dhe i shërben arritjes së objektivave të programeve mësimore të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Komunikimi.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Kolegji Universitar BEDER kryen veprimtaritë e tij në dy godina A dhe B. Të dyja godinat janë të marra me qera me një sipërfaqe totale 5628 m².

Godina A, është një godinë me tetë 8 kate dhe sipërfaqe 3957 m². Në godinën A ka si klasa mësimore ashtu edhe zyra administrative për fakultetet e departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Në godinën A është e vendosur edhe Biblioteka e Universitetit dhe Muzeu i Medias.

Godina B, është një godinë me dy kate dhe sipërfaqe 1671 m². Në godinën B zhvillohen mësim nga departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit.

Godinat ofrojnë si pajisje teknike ashtu edhe komoditet për studentët dhe pedagogët. Sallat e mësimit kanë kondicionerë. Në mjaft nga klasat ka “smart tabela” që krijojnë mundësi për interaktivitet në mësimdhënie. Gjithashtu ka edhe videoprojektorë.

Biblioteka, Muzeu, Laboratori i Informatikës:

Në katin 0 dhe -1 të godinës A, ndodhet edhe Biblioteka, muzeu i medias, salla e gjyqit të improvizuar laborator i informatikës.

Biblioteka ka një klasifikim të librave sipas Bibliotekës së Kongresit. Ajo ofron libra për studentët si në gjuhën shqip ashtu edhe në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht e turqisht. Ndërkohë në bibliotekë funksionon edhe një kompjuter i sistemit të kërkimit online, ku studentet mund të download libra të ndryshëm.

Nga vizita në Bibliotekën u informuam se shtimi me tituj të rinj të fondit bëhet përmes:

- Blerjeve të teksteve universitare dhe librave të reja, që janë pjesë e literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar;
- Porositë dhe blerjet online për botime periodike shkencore, etj.
- Dhurimi që bëjnë organizata e shoqata të ndryshme, ambasada të huaja, individë dhe fondacione.

Muzeu i medias ka disa pajisje të përdorura ndër vite që në fillesat e transmetimeve radio dhe televizione në vend, si kamera, pajisje riprodhuese, radio, pulte transmetimi, etj. Pajisjet janë mjaft interesante për të krijuar idenë e zhvillimeve historike të medias.

Një sallë e madhe seminaresh me kapacitet mbi 200 persona ndodhet në katin e parë pranë muzeut e cila përdoret për konferenca.

Aktivitetet extra kurikulare:

Në godinën B, krahas klasave dhe zyrave, ka edhe ambiente për veprimtari ekstra-kurrikulare. Aty ndodhet palestra, që studentët dhe personeli mund ta shfrytëzojnë për aktivitete individuale sportive.

Godinat e mësipërme janë të pajisura me mjetet për mbrojtjen kundër zjarrit, si edhe shkallët e emergjencës si dhe e pajisur me sistem ngrohje. KUB ka burime alternative për furnizimin me energji elektrike (motogenerator), si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm (depozita uji).

KUB ka ambjente hidrosanitare në çdo kat, rreth 47 bokse hidro-sanitare për studentët dhe personelin. KUB, për vetë arkitekturën që ka ofron mundësinë e ndriçimit natyral.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit (Tabelat 7.1 dhe 7.2 në Aneks)

KUB ka një infrastrukturë të organizuar mirë dhe me mjaft mjedise të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij dhe arritjen e synimeve të programit të studimit. Si nga dosja e vlerësimit të brendshëm ashtu edhe nga vëzhgimet në institucion, u vu re një mjedis cilësor dhe i përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit. Sallat e leksioneve dhe sallat e seminareve përmbushin nevojat e studentëve dhe pedagogeve në KUB dhe specifikisht në Departamentin e Shkencave të Komunikimit. Gjithashtu në shërbim të studentëve janë edhe ambiente të pajisura me Internet dhe shërbime mbështetëse si fotokopja, salla e bibliotekës etj.

Vlen për tu theksuar se Departamenti i Komunikimit ka dy elemente prioritarë në raport me universitetet e tjera dhe shkollat e gazetarisë që janë Muzeu i Medias dhe Laboratori krijues i medias, ku realizohet edhe portali online objektival. Institucioni përmbush standardet që lidhen me këtë tregues.

Mjediset e detajuara jepen në Tabelat 7. Sipas numrit aktual të studentëve në KUB institucioni ofron rreth 8.1 m²/student. (nga 2.5 m²/student që është normativa shtetërore)

Grupi i vlerësimit të jashtëm i vizitoi të gjithë ambientet që janë në shërbim të studentëve të programit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
<p>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</p> <p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka ndërtuar një mundësi për studentët që ata të kenë një këshilltar akademik. Roli i tij është i institucionalizuar në rregulloren mësimore. Kjo i ndihmon studentët të orientohen drejt në çdo fushë. Syllabuset e lëndëve kanë të përshkruar literaturën dhe mjaft prej teksteve mësimore janë të përditësuara. Kjo edhe për faktin se gazetaria dhe marrëdhëniet me publikun janë një degë në evoluim të vazhdueshëm dhe si e tillë ka nevojë për përditësim edhe të literaturës.</p> <p>Biblioteka e KUB zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të programit të studimit të gazetarisë, cikli i parë. Ajo është e hapur për studentët gjatë gjithë javës dhe ka një total prej rreth 36,000 tituj. Në biblioteka ka si librat e përzgjedhur dhe të klasifikuar, ashtu edhe botime periodike, të vendit dhe të huaja.</p> <p>Pasurimi i bibliotekës është bërë si nëpërmjet blerjes, ashtu edhe nismave dhe projekteve studentore. Një donacion i Ambasadës Amerikane ka sjellë mbi 300 libra në bibliotekë dhe më tepër se 200 prej tyre kanë qenë të dedikuar për studentët e gazetarisë.</p> <p>Kolegji Universitar BEDER parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor dhe kjo behët në përputhje me kërkesat e çdo departamenti specifik sipas programeve të studimit.</p> <p>Oraret e bibliotekës janë të njoftuara në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Gjatë sezonit të provimeve biblioteka qëndron e hapur edhe në fundjavë.</p> <p>Biblioteka e KUB ka edhe sistemin elektronik të marrjes së literaturës të nevojshme për studentët duke e kthyer atë në format të editueshëm duke lehtësuar punën e studenteve.</p> <p>Biblioteka e KUB ka një abonim në bibliotekën online Ebsco Host ku studentët kanë akses për rreth 45,000 libra dhe 5000 revista. Gjithashtu biblioteka e KUB mundëson komunikimin dhe në Book Academic Collection.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me</p>	<p>KUB ka mjedise që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla janë Qendra e medias dhe komunikimit, laborator i gjuhëve të huaja, laborator i kompjuterave, etj. (Këtu janë listuar vetëm ato që lidhen me Departamentin e Komunikimit). Kjo paraqitet edhe në numrat e klasave të</p>

qëllimet e programit;

Kriteri 3 Labororët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në labororët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

detajuar më lart.

Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Klasat janë të pajisura me tabela interaktive, projektorë, kompjuter, internet. Të gjitha mjediset mësimore, janë të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm.

Në ambjettet e dedikuara për lëndët e gazetarisë ka laboratorë funksionale të përshatshëm për programin e studimit të gazetarisë. (Laboratori i Gjuhëve të Huaja, Qendra e Medias dhe e Komunikimit, laborator i informatikës, redaksia e informacionit e portalit informativ www.objektiv.al)

Institucioni ka pajisje me programe të nevojshme për programin e studimit dhe editimit sipas kërkesave profesionale dhe praktike të studentëve të gazetarisë.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione të ndryshme mediatike, ku studentët zhvillojnë këto praktika. Por praktikat profesionale ofron edhe brenda KUB, siç është Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, revista Objektiv dhe portali me të njëjtin emër

Konkluzione të GVJ:

Kolegji Universitar BEDER ku përfshihet dhe Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Komunikimi ka mjedise optimale, infrastrukturë, teknologjitë e informacionit, bibliotekën, shërbimet e tjera për studentët, dhe rezidenca të cilat realizojnë më së mirë kriteret e përcaktuara. Studentët dhe stafi akademik në këtë program studimi e zhvillojnë procesin mësimor në një infrastrukturë që i plotëson standardet.

KUB ofron dy godina, me sistem kondicionimi dhe Interneti. Sallat e leksionit dhe sallat mësimore janë të pajisura me PC dhe projektor dhe tabela interaktive. Labororët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në zyra komode dhe funksionale. Përgjegjësit e departamenteve, dekanët, zv. Rektorët dhe drejtuesit e tjerë kanë zyra individuale. Në dispozicion të departamenteve dhe programeve të tyre janë dhe sallat e mbledhjeve, salla e konferencave, muzeu, biblioteka, etj.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Duke qenë një IAL privat dhe jo fitimprurës, Kolegji Universitar Bedër, pjesën më të madhe të të ardhurave në buxhetin e vet e krijon nga pagesat që vijnë nga studentët që ndjekin studimet, si dhe nga donacionet. Këto të fundit bëhen pjesë e buxhetit bazuar në kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Zë të ardhurash janë dhe konsulentat dhe shërbimet që KUB kryen për të tretët.

KUB procesin e financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare e bazon në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228,

datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si kërkesave që janë parashikuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit në këtë program studimi (në përqindje) jepen në Tabelën 8.1. Nga kjo Tabele si viti më i plotë është viti akademik 2016-2017, ku:

- Grantet për kërkim 1.1 %
- Konsulencat, shërbimet 0.1 %
- Tarifatat për dhe gjatë shkollimit 70 %
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj 28.9 %

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje) në 6 vitet e fundit në këtë program studimi jepen në Tabelën 8.2. Për vitin akademik 2016-2017, rezultton:

- Shpenzimet për Paga dhe sigurime 66.2 %
- Shpenzimet operative 33.8 %

Grupi i ekspertëve të jashtëm gjatë vizitës në institucion u njoh dhe me dokumentacionin mbi financimin dhe menaxhimin e burimeve financiare, duke evidentuar se të dhënat që paraqiten në materialin e ekspertëve të brendshëm përputhen, si për treguesit e të ardhurave dhe financimeve të ndryshme në 6 vitet e fundit, ashtu dhe për shpenzimet po në këtë periudhë.

Aspektet buxhetore për vitin akademik që përfundon, si dhe projektbuxheti për vitin e ri janë pjesë e raportimit të përvitshëm që KUB paraqet dhe për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>KUB realizon auditime të brendshme dhe të jashtme për vlerësimin e situatës financiare dhe menaxhimi financiar është nën kontrollin e Fondacionit "Hafiz Ali Korça", pjesë e të cilit është Kolegji. Raportet financiare hartohen bazuar në legjislacionin në fuqi, duke respektuar afatet, dhe duke pasqyruar detajisht të ardhurat dhe shpenzimet që kryen.</p> <p>Aspektet buxhetore për vitin akademik që përfundon, si dhe projektbuxheti për vitin e ri janë pjesë e raportimit të përvitshëm që KUB paraqet dhe për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me raportime të natyrës financiare, si dhe të auditimeve të brendshme dhe të jashtme. Aty janë përfshirë pjesa e të ardhurave, sic janë ato nga tarifatat e studimit të studentëve, nga donacionet vendase apo të huaja, të ardhura nga pjesmarrja në projekte të ndryshme a si konsulenca etj. Gjithashtu përfshihen dhe pjesa e shpenzimeve të</p>

realizuara për funksionalitetin e KUB, apo dhe zëri i buxhetit për bursat e akorduara si mbështetje për studentët të ndryshëm.

KUB me statusin e një IAL-je jofitimprurëse procesin e financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare e bazon në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si kërkesave që janë parashikuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.

VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifët e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Në mënyrë të përvitshme KUB harton raportin financiar nga një kontabilist i miratuar, dokument që përfshin zërat e të ardhurave, duke specifikuar burimet që vijnë nga pagesat që bëjnë studentët si tarifë studimi për nivelin e parë, donacionet nga brenda dhe jashtë vendit, nga konsulenca të ndryshme etj. Gjithashtu dokumenti përmban të detajizuar dhe zërat e shpenzimeve që kryen, si ato në formën e pagave dhe honorareve për mësimdhënien, apo dhe shpenzime të tjera administrative e operative në funksionalitetin e të gjithë institucionit.

Ky dokument arkivohet pranë fondacionit dhe KUB, sic e përmendëm më sipër bazohet në procesin e raportimit financiar tek kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si kërkesave që janë parashikuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.

KUB respekton dhe afatin e raportimit për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke e kryer cdo fundviti. Pjesë e këtij raportimi është dhe buxheti për vitin që ka kaluar, projekcioni për buxhetin e vitit të ri, si dhe projektbuxheti afatmesëm.

Gjatë njohjes së dokumentacionit mbi financimin dhe menaxhimin e burimeve të financimit grupi i ekspertëve të jashtëm vërejtë qëndrueshmëri në realizimin e këtij programi studimi, duke krijuar mendimin se KUB ka kapacitete të mjaftueshme për të mbajtur këtë trend edhe për kohën vijuese, në favor të përmirësimit të situatës financiare në institucion dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme.

Konkluzionet e vlerësimit:

Grupi i ekspertëve të jashtëm evidentoi se KUB vit për vit harton raportin financiar nga një kontabilist i miratuar. Ky dokument që përfshin zërat e të ardhurave, duke specifikuar burimet që vijnë nga pagesat që bëjnë studentët si tarifë studimi për nivelin e parë, donacionet nga brenda dhe jashtë vendit, nga konsulenca të ndryshme etj.

Dokumenti që arkivohet pranë fondacionit, pjesë e të cilit është KUB, bazohet në procesin e raportimit financiar tek kërkesat e Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", në Ligjin nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat

Financiare”, si kërkesave që janë parashikuar në akte të tjera nënligjore që janë në fuqi.

Gjatë njohjes së dokumentacionit mbi financimin dhe menaxhimin e burimeve të financimit ekipi i ekspertëve të jashtëm vërejti qëndrueshmëri në realizimin e këtij programi studimi, duke krijuar mendimin se KUB ka kapacitete të mjaftueshme për të mbajtur këtë trend edhe për kohën vijuese, në favor të përmirësimit të situatës financiare në institucion dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Kolegji Universitar Bedër ka ndërtuar një sistem brenda institucionit që ndjek dhe ka përgjegjësinë për aspektet e sigurimit të cilësisë në përgatitjen e studentëve, bazuar në standardet dhe kërkesat e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Pjesë e këtij sistemi të brendshëm është dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC, që ka 5 anëtarë, (3 pedagogë të brendshëm, 1 student dhe 1 ekspert i jashtëm).

NJSBC ka kompetencë të mbështesë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik; të mbështesë Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit për të hartuar standardet për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë; të vlerësojë, në mënyrë periodike, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit, në përputhje me standardet; të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji, në bashkëpunim me njësitë përkatëse; të hulumtojë në lidhje me modelet e ndryshme, në kuadër të përmirësimit të cilësisë, që mund të merren si shembull, si edhe shpërndarjen e tyre në njësitë e tjera akademike dhe administrative; të njoftojë njësitë për vendimet e marra, të mbikëqyrë zbatimin e procesit të punës në kuadrin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron rezultatet e kësaj pune; të ndjekë procesin e vlerësimit të brendshëm të institucionit, si dhe mbikëqyrjen e përgatitjes së raportit të vetëvlerësimit; të ndjekë përgatitjen e terrenit për ‘vlerësimin e jashtëm’ të KUB dhe vënien në dispozicion të institucionit ose organizatës së vlerësimit të jashtëm të çdo informacioni të nevojshëm.

NJSBC ka në përgjegjësinë e vet dhe organizimin e pyetësorit studentor (në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve), me fokus vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në bashkëpunim me sekretarinë mësimore. Këto vlerësime raporton në Senatit Akademik të KUB.

Veç NJSBC-së, bazuar në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe aktet rregullative të miratuara nga MASR dhe vetë institucioni, Kolegji për sigurimin e cilësisë, ka në funksion dhe Komisionin e përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin, si dhe Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.

Këto struktura, ashtu si NJSBC, ndikojnë në hartimin e politikave për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron, por dhe për ndjekjen konkrete të rezultateve përmes vlerësimit me anketime në rrafsh të ndryshme. Rezultatet ndahen me secilin punonjës akademik, duke ja bërë me dije në mënyrë individuale.

Në takimin me përfaqësues të NJSBC-së, apo dhe në takimin që grupi ekspertëve të jashtëm zhvilloi me drejtesit e departamentit dhe të stafit akademik u evidentua realizimi i vlerësimit të personelit të angazhuar dy herë brenda vitit akademik, në fund të semestrit dhe në mbyllje të vitit, vlerësim që në 6 vitet e fundit ishte standardizuar, sipas një rregulloreje të posaçme. Vlerësimi bëhet në të paktën tre rrafsh: vlerësim i studentëve për personelin, vetëvlerësim për personelin, vlerësim i eprorëve për vartësit etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - o Sa anketime kanë bërë me studentët
 - o Sa studentë janë anketuar
 - o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - o Etj

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Në janar 2010, KUB është pajisur me certifikatën ISO 9001:2008 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë. Përveç vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve që përmendëm më sipër, në KUB aktivizohet nga rektorati dhe një komision i brendshëm ad-hoc, i cili auditon njësitë akademike dhe administrative mbi ligjshmërinë e administrimit të dokumentacionit të brendshëm. Grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh dhe me formatin e mënyrës se si realizohet auditimi i brendshëm, përmes evidencës përkatëse, për metodologjinë, synimet dhe ndërhyrjet që realizon komisioni në rastet kur ka mospërputhje të dokumentacioni me dispozitat statutoore dhe të rregulloreve.

Pjesë e vlerësimit të brendshëm janë dhe treguesit e infrastrukturës dhe shërbimeve logjistike. Në KUB ky vlerësim zhvillohet një herë në vit, me synimin e tërheqjes së mendimeve dhe sugjerimeve në favor të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve që ofrohen për studentët, stafin akademik, si dhe personelin mbështetës.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Përmes anketimit me studentët janë mbledhur vlerësime të tyre për metodologjinë e mësimdhënies për secilën lëndë, për aspekte të korrektesës së pedagogëve në auditor, për leksionet, seminarët, komunikimin, mbështetjen me konsultime etj. Anketimet me studentë zhvillohen dy herë në vit, para provimeve finale të çdo semestri.

Nga vetëvlerësimi i njëjësive bazë në KUB, hartohet një raport vjetor që i paraqitet rektoratit. Janë organizuar prezantime të hapura të këtyre raporteve vjetore të vetëvlerësuesve ku janë prezent të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten.

KUB realizon dhe kualifikime të personelit në fushën e kërkimit shkencor, trajnime që janë mbështetur nga NJSBC dhe zyra e burimeve njerëzore me synimin e garantimit të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.

- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Grupi i ekspertëve të jashtëm shqyrtoi dokumenta që lidheshin me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, si dhe përpjekjet e institucionit për përmirësimin e saj në komponentët e zbatimit të kurrikulës dhe kërkimit shkencor. Për këtë aspekt grupi i njoh me mënyrë e raportimit vjetor në MASR, me formatin e evidencës për mënyrë e realizimit të auditimit të brendshëm, me formatin e anketës që plotësohet dy herë në vit nga studentët (para dhënie së provimeve të sezonit), udhëzimin mbi procesin e zhvillimit të kurrikulave, përmbajtjen e planit strategjik për periudhën 2018-2023, si dhe të mëparshmin 2012 – 2017, vendimin e senatit të KUB për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme të vlerësimit të brendshëm etj. Ky dokumentacion ndikon pozitivisht në garantimin e cilësisë për njësitë përbërëse të Kolegjit, si dhe në tërësi të institucionit

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi,	

instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.

Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;

Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;

Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:

Të tërthorta:

- Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;
- Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;
- Pyetje konceptuale;
- Intervista;
- Etj.

Të drejtpërdrejta:

- Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);
- Dëgjime në auditor;
- Vlerësimi me nota/pikë;
- Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktike;
- Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);
- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- Etj.

Për ecurinë e programeve të studimeve, KUB përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese, mes tyre është ngritja dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC. Gjithashtu ekziston dhe një Komision i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit. Gjatë takimit me përfaqësues të këtyre strukturave, grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me strukturën e tyre, angazhimin, kompetencat, procesin e raportimit etj. Angazhimi i drejtëpërdrejtë ishte për zhvillimin dhe monitorimin e anketës me studentët për personelin akademik dhe përmbajtjen e lëndëve.

Në vlerësimin e cilësisë së angazhimit të pedagogëve KUB, si për cdo njësi të institucionit dhe për ecurinë në programin Bachelor në shkencat e komunikimit, ndjek mbledhjen e të dhënave nga anketime, të paktën në tre rrafshë: Pedagogët vlerësohen për efektshmërinë e tyre nga studentët; vetvlerësohen; si dhe i nënshtrohen një vlerësimi nga eprori i tyre në Departamentin ku përfshihet program që është fokus.

Grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh me formatin dhe raste konkrete të vlerësimit që bënin studentët për pedagogun dhe ecurinë e lëndës, që realizohej sistematikisht dy here në një vit akademik, në fund të semestrit të parë (para provimeve), si dhe në fund të vitit (para provimeve të semestrit të dytë).

Aktiviteti i këtyre strukturave ishte pasqyruar dhe në një nënfaqe të vecantë të eëë.beder.edu.al. Por nga kqyrja e eëë.qac.edu.al u vu re që nuk ishte e aktualizuar në informacionin për dinamikën e angazhimeve dhe kalendarin e veprimtarive të pritshme.

Informacionin mbi vetëvlerësimin institucional në shkallë hierarkike, KUB e përfshin në raportet vjetore që paraqet në MASR çdo fundviti akademik.

Kolegji kujdeset që rezultatet e vlerësimit në të gjitha rrafshet të publikohen në ëbsite-n zyrtar, si një mundësi e ndjekjes nga grupi i interesit (studentë, pedagogë, punonjës të administratës etj). Gjithashtu KUB ka vendosur në faqen e internetit dhe dokumentet e planit strategjik institucional për periudhën 2012 – 2017, si dhe për 2018 – 2023.

Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe në atë të zbatimit të programeve të studimeve, përmes metodave të tërthorta, si psh zhvillimi i anketave në fund të dy semestrave, material që shërben për të ndjekur konkretisht performancën si dhe për të shikuar nevojat për përmirësime në dobi të mbarëvajtjes e kurrikulës, të marrëdhënieve pedagog – student etj. Interesimi për mendimet dhe gjykimet e studentëve orientohen në aspekte të tilla, si mbi përmbajtjen e lëndës, mbi performancën e pedagogut të lëndës, mbi shërbimin që ofrohen në institucion etj.

Por aplikohen dhe metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimet me pikë për pjesën e aktivizimit të tyre në auditor, për realizimin e detyrave të kursit, për praktikën, përfshirjen në projekte, vlerësim për testin pjesor, apo atë përfundimtar etj.

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Kolegji ka arritur të finalizojë dy akreditime, në vitin 2013 nga APAAL dhe në vitin 2017 nga agjencia britanike, "Quality Assurance Agency" në bashkëpunim me ASCAL.

Bazuar në kuadrin legjislativ në fuqi, si dhe aktet rregullative të miratuara nga MASR dhe vetë institucioni, Kolegji për sigurimin e cilësisë, ka në funksion Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC; Komisionin e përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin; si dhe Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.

Këto struktura ndikojnë në hartimin e politikave për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron, por dhe për ndjekjen konkrete të rezultateve përmes vlerësimit me anketime në rrafsh të ndryshme. Rezultatet ndahen me secilin punonjës akademik, duke ja bërë me dije në mënyrë individuale.

Ideimi, përcaktimi i politikave të zhvillimit të KUB bëhet nga Senati, si organ kolegjal dhe vendikmarrës, drejton, bashkërendon dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre.

Propozimet për ndryshimin e programeve mësimore përcillen për në Senat duke pasur parasysh parimin hierarkik vertikal: departament - fakultet - rektorat. Procesi i ndryshimit të kurrikulave bëhet nën koordinimin e zyrës së menaxhimit të kurrikulave.

Rëndësia e cilësisë dhe siguri i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor shpjegohen dhe nxiten përmes dokumenteve të tilla, si Manuali i Sigurimit të Cilësisë, Guida e Studentëve dhe ajo e personelit, me të cilat u njoh dhe grupi i ekspertëve të jashtëm gjatë vizitës dhe takimeve në Kolegj.

Që me miratimin e planit të parë strategjik 5 vjeçar për periudhën 2012–2017 është përfshirë dhe pjesa për përmirësimin sistematik të cilësisë. Gjithashtu dhe kjo është pjesë dhe e dokumentit strategjik që është në fuqi, për periudhën 2018–2023, fokusuar në tri fusha kryesore: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut në shoqëri. Ky dokument strategjik është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e Kolegjit dhe janë të shkarkuara në ëbsite-n e tij.

Konkluzionet e vlerësimit:

Kolegji për sigurimin e cilësisë, ka në funksion Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC; Komisionin e përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin; si dhe Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.

Këto struktura ndikojnë në hartimin e politikave për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron, por dhe për ndjekjen konkrete të rezultateve përmes vlerësimit me anketime në rrafsh të ndryshme. Rezultatet ndahen me secilin punonjës akademik, duke ja bërë me dije në mënyrë individuale.

Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe në atë të zbatimit të programeve të studimeve, përmes metodave të terthorta, si psh zhvillimi i anketave në fund të dy semestrave, material që shërben për të ndjekur konkretisht performancën si dhe për të shikuar nevojat për përmirësime në dobi të mbarëvajtjes e kurikulës, të marrëdhënieve pedagog – student etj. Interesimi për mendimet dhe gjykimet e studentëve orientohen në aspekte të tilla, si mbi përmbajtjen e lëndës, mbi performancën e pedagogut të lëndës, mbi shërbimin që ofrohen në institucion etj.

Që me miratimin e planit të pare strategjik 5 vjeçar për periudhën 2012 – 2017 është përfshirë dhe pjesa për përmirësimin sistematik të cilësisë. Gjithashtu dhe kjo është pjesë dhe e dokumentit strategjik që është në fuqi, për periudhën 2018 – 2023, fokusuar në tri fusha kryesore: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut në shoqëri. Ky dokument strategjik është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e Kolegjit dhe janë të shkarkuara në website-n e tij.t.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Departamenti i Shkencave të Komunikimit ku përfshihet dhe programi i studimit në Bachelor për Shkenca Komunikimi ka për mision përgatitjen e studentëve që ndjekin tri vitet në kualifikimin e tyre në fushën e gazetarisë, komunikimit dhe marrëdhënieve publike dhe në fusha të ngjashme e ndërlidhura me to, duke u bazuar vlerat universale, si dhe duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, të përhapjes në shkallë të gjerë internetit dhe mediave të reja, si dhe mënyrës se si “ushqehet” sot me informacion publiku dhe si e realizojnë dhe shpërndajnë produktin redaksitë mediatike.

Nga biseda me përfaqësues të stafit akademik, studentët dhe ata të zyrave përkatëse të institucionit konvergimi për vizionin e këtij programi studimi ishte harmonizimi i dijeve teorike dhe praktike, për t'i dhënë studentëve njohuri bazike dhe të thelluara, por duke realizuar në nivele të ndryshme dhe familjarizimin me punën e tyre në terren, brenda dhe jashtë redaksive, studiove a zyrave për marrëdhëniet me publikun etj., duke treguar profesionalizëm dhe duke respektuar kodet etike dhe parimet deontologjike.

Një student që ndjek programin Bachelor në Shkenca Komunikimi ka disa destinacione punësimi:

- Në redaksi mediatike, publike ose private, në median print, audio dhe audiovizive, në median online apo agjenci të lajmeve etj. Brenda tyre ai mund të kontribuojë si gazetar, reporter, redaktor, ose drejtues dhe menaxher redaksie, mund të mbulojë një profil gjeneralist, ose të profilizuar (sport, ekonomi, politikë, kulturë, sociale etj).

- Në organizma, organizata e shoqata vendase dhe të huaja, të cilat operojnë në fushën e edukimit/komunikimit, shërbimeve, edukatës qytetare dhe si operator e kurator i marrëdhënieve ndërkombëtare, në administratën publike e private, etj.
- Në njësitë mediatike (në departamente apo zyra) të marrëdhënieve me publikun pranë institucioneve publike e private, formacioneve politike, sipërmarrjeve dhe kompanive të biznesit etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit

Dy janë programet e studimit të Departamentit të Shkencave të Komunikimit në Fakultetin e Shkencave Humane në KUB, të nisura që nga viti akademik 2011 – 2012: Bachelor në Shkenca Komunikimi dhe Master Shkencor në Shkenca Komunikimi (profili Gazetari dhe profili Marrëdhënie publike). Ky strukturim krijon një hapësirë interesi për studentët që pas përfundimit të tre viteve të studimit në Bachelor të kenë mundësi që sipas aftësive dhe prirjeve të ndjekin një nga dy profilet e Masterit shkencor. Por dhe për atë studentë të kësaj fushe që vijnë nga institucione të tjera të larta arsimore dhe bashkohen me programin e KUB, krijohet mundësi dhe interes për vijimin pa pengesa të studimeve, duke respektuar gjithmonë rregullat dhe kërkesat në fuqi të transferimit.

Stafi akademik, sipas vlerësimit të grupit të ekspertëve të brendshëm është i angazhuar “për të edukuar, për të zgjeruar njohuritë rreth fushës të mbështetura në baza të etikës profesionale, përgatitje të studentëve në hartimin e kujdesshëm të mënyrave të analizimit të fakteve dhe situatave të ndryshme, shkrimi saktë i informacionit dhe dhënia studentëve e një kulture të gjerë pluraliste në mënyrën e mendimit dhe konceptimit të situatave”.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- Viti akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe provimet finale.
- Semestri ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe provimin final
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 50 min (Kohëzgjatja e orës së mësimit nga 60 min është bërë 50 min bazuar në ndryshimet që janë bërë nga MASR).

KUB, ashtu si dhe në programet e tjera, ju jep diplomën studentëve që ndjekin Bachelor në Shkenca Komunikimi, kur ata shlyejnë të gjitha detyrimet brenda afateve kohore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Diplomat e ciklit të parë të studimeve shoqërohen dhe me një suplement që hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës europiane të arsimit të lartë dhe përshkruan aspekte të tilla, si natyra e programit, niveli, përmbajtja, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfunduar nga studenti etj. Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës përcaktohen nga Senati Akademik, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Grupi i ekspertëve të jashtëm e pa konkretisht modelin e diplomës që fiton një student që mbaron ciklin e parë, Bachelor në Shkenca Komunikimi, si dhe suplementin shoqërues të këtij dokumenti.

Çdo formë diplome ose certifikate, përpara se të lëshohet, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor që mbahet në ministrinë përgjegjëse për arsimin.

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabelat 10 në Aneks)

Bazuar në planin mësimor që pasqyrohet për të tre vitet e këtij programi studimi, grupi i ekspertëve të jashtëm, evidentoi se në përgjithësi ndarja e lëndëve është në funksion të natyrës së njohurive dhe shprehive që merr

studenti në ndjekjen e nivelit të parë në Shkencat e Komunikimit, por dhe si shpërndarje e drejtë e ngarkesës me lëndët në 6 semestrat. Ndoshta do të jetë mirë që lënda “Metodat e redaktimit”, e cila aktualisht zhvillohet në vitin e dytë të kalojë në vitin e tretë (pasi studenti zhvillon një sërë lëndësh profesionale të domosdoshme në dy vitet e para). Dhe lënda “Historia e integritit dhe institucionet e BE-së”, që zhvillohet në vitin e tretë mund të afrohet duke u zhvilluar në vitin e dytë. Kjo lëvizje nuk do të prishë as sasinë e nevojshme të krediteve të fituara nga studentit (60) në secilin vit akademik.

Tek kreditet për secilën lëndë, ndoshta do të jetë më mirë që për tre prej tyre: “Hyrje në komunikim masiv”, “Hyrje në sociologji” dhe “Marrëdhënie publike” që kanë 4 kredite (ECTS) – të bëhen me 5 kredite. Dhe tre prej tyre: “E drejta kushtetuese”, “Hyrje në Informatikë” dhe “Anglisht / Anglisht e avancuar” të bëhen me 4 kredite. Ky rivlerësim shkon në favor të zhvillimit të lëndëve profesionale, por nuk prish dhe balancat për numrin total të ECTS për secilin vit akademik.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Ndarja e orëve në auditor për leksionet, seminarët, praktikat lëndore dhe provimin përfundimtar, si dhe orët e pavaruara të studentit janë si më poshtë:

- Leksionet	1568 orë në auditor dhe 1641 orë punë e pavarur e studentit
- Seminarët	272 orë në auditor dhe 136 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikata lëndore	48 orë në auditor dhe 57 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar	72 orë në auditor dhe 706 orë punë e pavarur e studentit

Kjo ndarje vlerësohet nga grupi i ekspertëve të jashtëm si e drejtë, bazuar me objektivat e lëndëve dhe peshën e tyre në të gjithë kurrikulën e programit të studimit.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 12 në Aneks)

Deri më tani nuk ka ndryshime në planin mësimor, që pas asaj që është licencuar dhe është zbatuar në vitin e parë akademik kur ka nisur ky program studimi (2011 – 2012). Megjithatë Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka dorëzuar pranë MASR një dosje ku bëhen propozime për riorganizimin e këtij program, si dhe hapjen e programeve të tjera.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabelat 13 në Aneks)

Stafi Akademik që është angazhuar në programin e studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi, si ata me kohë të plotë, ashtu dhe ata me kohë të pjesshme, ruan në tërësi raportin e drejtë të profilit të ekspertizës që ka secili prej tyre (fushën ku është fokusuar), me natyrën e lëndës që i është caktuar. Qëndrueshmëria vit pas viti akademik e stafit të angazhuar është një tregues pozitiv në mbarëvajtjen e programit. Mjaft nga pedagogët me kohë të pjesshme të afruar nga Departamenti për këtë program janë personalitete në fushën e gazetarisë dhe komunikimit, gjë që reflekton një vlerë të shtuar në zbatimin e planeve mësimore, në harmonizimin e njohurive teorike me shprehitë praktike profesionale.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Për vlerësimin e syllabus-eve grupi i ekspertëve të jashtëm shqyrtoi veç shembullit të paraqitur në raportin e vlerësimit të brendshëm edhe të tjera. E përbashkëta ishte se ato ishin të standardizuara në kërkesat që për prezantimin e të dhënave kryesore mbi lëndën, si një përmbajtje që qartësonte studentin që në fillim të procesit mësimor mbi komponentët e domosdoshëm që duhen ditur, në favor të lehtësimit të ndjekjes së saj gjatë zhvillimit në auditor.

Në syllabus-e përfshiheshin elementë të tillë si, emërtimi i lëndës/modulit; viti/semestri kur zhvillohet lënda; mri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën; vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit; njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës; çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë; temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik; ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS; format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre; format e vlerësimit të studentëve; detyrimet e studentit për lëndën dhe literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.

Këto të dhëna ishin të përfshira tek lëndët e programit Bachelor në Shkenca Komunikimi, për secilin vit. Gjatë bisedës me anëtarët e stafit akademik dhe drejtuesit e Departamentit u fokusuan dhe tek procesi i përgatitjes, dorëzimit dhe miratimit të syllabus-eve. Shefi i Departamentit ndërhynte në plotësimin rigoroz të tyre, sidomos tek pjesa e aktualizimit të literaturës së detyrueshme dhe asaj ndihmëse. Ndryshimet e syllabus-eve vinin dhe si reflektim i mendimeve dhe sugjerimeve që kishin studentët mbi mbarëvajtjen e lëndës.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Përmbajtja e një syllabus-i ka ndryshuar në periudha të ndryshme, që pas vitit të parë akademik të KUB-it, 2011 – 2012, kur dhe është hapur dhe program i studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi. Në rang Kolegji, por dhe njësie bazë, janë organizuar dhe workshop-e me pedagogët me kohë të plotë, por sidomos ata me kohë të pjesshme, përmes të cilëve diskutohet përgatitja e tyre sipas standardit. Përgjegjësi i Departamentit tregoi disa raste, sidomos me pedagogët e jashtëm, kur ishte kërkuar ndihmë për paraqitjen e tyre, me plotësim të të gjitha rubrikave përbërëse.

Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi ishin me disa rubrika dhe nënrubrika që në tërësinë e tyre jepnin një pasqyrë të plotë të lëndës (përshkrimin dhe objektivat), temat javë pas jave, literature (e detyruar dhe ajo ndihmëse), mënyra e vlerësimit për studentin, aktivitetet që parashikoheshin etj. E detyrueshme ishte që pedagogët për secilën lëndë duhet ta paraqesin tek grupi i studentëve që në orën e parë në auditor, duke bërë dhe shpjegime për secilin aspekt, si dhe duke iu përgjigjur interesit të studentëve për paqartësi apo informacion shtesë. Syllabus-et ndiqen nga studentët virtualisht përmes sistemit BIS dhe shkarkohen në website-n zyrtar të Kolegjit tek hapësira informative e Departamentit të Shkencave të Komunikimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Kolegji Universitar Bedër UB ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, bazuar në Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Edhe programet e studimit të Departamentit të Shkencave të Komunikimit, në Bachelor dhe në Master Shkencor janë akredituar në vitin 2013. Programi që është në fokus (Bachelor në Shkencat e Komunikimit) është në stad rivlerësimi dhe zhvillohet bazuar në kushtet dhe kërkesat e programit të licencuar nga MASR.</p> <p>Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një programi Bachelor në Shkenca Komunikimi, me kohë të plotë, është 60. Kjo evidentohet në programin e studimit që është akredituar rreth 6 vite më parë, si dhe në dokumentacionin e shqyrtuar aktualisht në këtë proces riakreditimi.</p>

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.

Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;

Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Kolegji si dhe Fakulteti i Shkencave Humane, ku përfshihet dhe program në fokus shpërndajnë për studentët që ndjekin studimet, si dhe për cilindo të interesuar informacione dhe shpjegime për aspekte thelbësore të zhvillimit të ciklit të parë. Informacioni jepet në rang njësie kryesore (faqen online të fakultetit) dhe njësie bazë (të departamentit), ku përfshihen programet e studimit, personeli akademik, kurrikulat i angazhuar, syllabus-et e lëndëve, njoftime të ndryshme orientuese. Këto njohuri shpërndahen dhe në formën e fletëpalosjeve apo në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kontakti në sekretarinë mësimore.

Në informacionin që jepet virtualisht, print, apo në mënyrë të drejtpërdrejt përfshihet dhe lista e lëndëve që janë të detyrueshme apo ato që studenti i ka me zgjedhje.

Që në javën e parë të fillimit të studimeve në cdo vit akademik studentët njihen dhe me procesin e frekuentimit të programit, ngarkesën, orët që do të zhvillohen në auditor etj. Kjo u evidentua dhe gjatë takimit që grupi i ekspertëve të jashtëm zhvilloi me studentët e Bachelor për Shkenca Komunikimi.

Studentëve u ofroheshin dhe të gjitha syllabus-et për lëndët që do të zhvillonin në semestër, për format e zhvillimit të saj, vlerësimi, etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

KUB ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, bazuar në Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, i tillë është dhe program Bachelor në Shkenca Komunikimi që është akredituar në vitin 2013.

Stafi Akademik që është angazhuar në programin e studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi, si ata me kohë të plotë, ashtu dhe ata me kohë të pjesshme, ruan në tërësi raportin e drejtë të profilit të ekspertizës që ka secili prej tyre (fushën ku është fokusuar), me natyrën e lëndës që i është caktuar. Qëndrueshmëria vit pas viti akademik e stafit të angazhuar është një tregues pozitiv në mbarëvajtjen e programit.

Për studentët jepet informacion për aspekte thelbësore të zhvillimit të ciklit të parë, si përmes faqes online të fakultetit ashtu dhe përmes faqes së departamentit, ku përfshihen programet e studimit, personeli akademik, kurrikulat i angazhuar, syllabus-et e lëndëve, njoftime të ndryshme orientuese. Në informacionin që jepet virtualisht, print, apo në mënyrë të drejtpërdrejt përfshihet dhe lista e lëndëve që janë të detyrueshme apo ato që studenti i ka me zgjedhje.

Grupi i ekspertëve të jashtëm mendon se programi i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Komunikimi është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Kolegjit dhe mbi këtë program jepen informacione dhe shpjegime për të gjithë studentët që e ndjekin atë aktualisht. Ndaj dhe shprehet se i plotëson standardet.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësishë etj.

KUB në çdo fillim viti akademik ndjek një paketë masash për mbarëvajtjen e procesit mësimor sipas planeve të miratuara në rang institucioni, njësie kryesore apo njësie bazë. Objekt është verifikimi i ngarkesës mësimore për stafin akademik me kohë të plotë apo me të pjesshme, shpërndarja e lëndëve, dorëzimi i syllabuse-eve etj. Një grup pune i emëruar me urdhër të rektorit të Kolegjit ndjek gjithë këtë proces në mënyrë kapilare, në rang fakulteti, departamenti dhe programi konkret studimi në dy nivelet, Bachelor e Master.

Për programin që është në shqyrtim punohet për kombinimin e teknikave të ndryshme të mësimdhënies, duke përfshirë krahas leksioneve dhe seminareve edhe zhvillimin e orëve të hapura të mësimi ku vijnë të ftuar ekspertë nga fusha e gazetarisë e komunikimit, të cilët fokusohen në përvoja konkrete të terrenit, duke analizuar dhe prezantuar problematika e trende. Gjithashtu diskutime dhe prezantime zhvillohen dhe në institucione mediatike, gjatë vizitave të studentëve në njësi mediatike publike ose private. Realizimi i detyrave të kursit është një tjetër format në kontrollin e njohurive dhe shprehive të studentëve, duke i angazhuar ata në një produkt konkret nga tematika që përfshihet në programin e lëndës.

Në programin e studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi ndiqet metoda e harmonizimit të aspekteve teorike me ato praktike, "learning by doing".

Gjatë zhvillimit të procesit mësimor në auditor, pedagogët bëjnë në mënyrë sistematike kontroll të njohurive të studentëve, si gjatë diskutimeve në grup ashtu dhe përmes prezantimeve individuale të tyre. Ndiqen format standarde të provimeve të pjesshme si dhe ato finale, ndërkohë që studentët paraqesin dhe projekte në grup ose individuale. Grupi i ekspertëve të jashtëm u njoh dhe me një rregullore për realizimin e provimeve që zbatohet në të gjithë Kolegjin, përfshirë dhe programin e studimit që është në fokus. Por sikundër dhe e kemi përmendur më sipër, studentët në fillim të semestrit njihen me format e kontrollit të njohurive dhe strukturë e vlerësimit të tyre për secilën prej lëndëve që do të zhvillojnë. Pjesë e syllabus-it është dhe rubrika e mënyrës së vlerësimit të lëndës, e cila jep të ndarë në përqindje komponentët e notës (provimi pjesor, angazhimi në auditor, projekti ose detyra e kursit etj.). Bazuar në rezultatet që fiton studenti në shlyerjen e detyrimeve përllogaritet dhe kreditet sipas sistemit evropian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve, ose ECTS.

Duke qenë me grup me numër jo të madh studentësh, programi Bachelor në Shkenca Komunikimi është më i përfshirë gjatë seancave të seminareve apo diskutimeve, sic dhe u shprehën vetë studentët gjatë takimit me grupin e ekspertëve të jashtëm. Në kualitetin e mësimdhënies ndihmon shumë dhe infrastruktura brenda auditorëve, kushtet akomoduese, sistemet e kondicionimit të ajrit, tabelat interaktive (smart board-et), rrjeti i kompjuterave, aksesit në internet (wi-fi). Salla e multimedias ku zhvillojnë orë tëndryshme mësimi studentët e Departamentit të Shkencave të Komunikimit, përfshirë dhe programin që është fokus, ka kushte komforte për punën në grup, si dhe atë individuale, duke punuar si në kushtet e një redaksie mediatike apo zyre PR-i.

Për angazhimin e pedagogëve në procesin mësimor dhe teknikat që ata përdorin për mësimdhënien merren vlerësime nga studentët dhe gjatë anketave që ata zhvillojnë dy herë brenda vitit akademik. Mendimet dhe propozimet e studentëve vlerësohen nga departamenti në favor të përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Gjithashtu për garantimin e standardeve cilvsores nga ana e stafit akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, burimet njerëzore dhe NJSBC-ja organizojnë dhe trajnime e çorkshop-e

Vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të mbledhura nga anketat me studentët për çdo lëndë dhe pedagog. Varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies. Duke synuar garantimin e cilësisë në mësimdhënie, si edhe kualifikimet e personelit në fushën e kërkimit shkencor, KUB gjatë kësaj periudhe ka organizuar disa trajnime, të cilat janë mbështetur nga NJSBC dhe zyra e burimeve njerëzore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet** (Tabela 16 në Aneks):

Struktura e ngarkesës në auditor (raporti mes pjesës kohore për trajtimin e temave në leksione, për seminarët, apo për praktikën dhe provimin final) është në proporcion të drejtë, në favor të krjimit të kohës së domodoshme për marrjen e njohurive dhe diskutimit rreth tyre, por dhe përfshirjes së studentëve në shprehjet praktike të lëndës. Kjo strukturë ngarkese ishte dhe pjesë e bashkëbisedimit që realizoi grupi i ekspertëve të jashtëm me studentë të këtij programi studimi dhe stafin akademik, dhe në tërësi opinionet ishin me vlerësime pozitive duke e përshkruar si të dobishme dhe funksionale.

- Format e kontrollit të njohurive** (Tabelat 17 në Aneks)

Secili pedagog kur paraqet syllabus-in e lëndës në Departament dhe pas miratimit aty kur ja prezanton studentëve në fillim të semestrit, aty përfshihet dhe një rubrikë për format e kontrollit të njohurive. (Ilustrimi i mësipërm është një rast konkret në programin studimor që është në fokus). Vec kontrollit në mënyrë sistematike të njohurive të studentëve, si gjatë diskutimeve në grup ashtu dhe përmes prezantimeve individuale të tyre, realizohen dhe provimi i pjesshëm dhe ai final.

Nga shqyrtimi i formave të kontrollit për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi vihet re se proporcioni për zërat e vlerësimit ka dhe ndryshime tek anëtarë të ndryshëm të stafit akademik, në varësi të natyrës së lëndës që ata udhëheqin. Ndarja e zërave në përqindje qëllon që “peshon” më shumë psh për detyra kursi, apo elementë të tjerë, pasi kjo varet nga karakteri teorik apo aplikativ i një lënde dhe formës më të përshtatshme që gjen pedagogu për formën e kontrollit të njohurive dhe shprehive që marrin studentët gjatë zhvillimit të saj. Në vlerësimin e grupit të ekspertëve të jashtëm format e kontrollit për lëndët e këtij programi janë të rregullta.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë** (Tabelat 18 në Aneks)

Angazhimi i studentëve është në disa forma, psh., përfshirje në punime shkencore individuale të pedagogëve, në projekte shkencore në rang departamenti apo në rang fakulteti etj.. Studentët e programit të studimit bachelor në Shkenca Komunikimi janë aktivizuar dhe në disa veprimtari të Departamentit në formatin e paneleve të diskutimit ose ëorkshop-e, që janë fokusuar tek marrëdhënia e medias me audiencat në epokën digjitale; shoqëria e hapur, demokracia dhe edukimi si armë kundër ekstremizmit; fake neës –problem i medias apo i demokracisë; etj.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Sa i takon procedurave për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve, përfshirë këtu dhe ata të Shkencave të Komunikimit, baza ligjore ka qenë ligji nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” deri në vitin 2015. Më pas janë zbatuar kërkesat e ligjit, Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Një student në Bachelor për tre vitet e studimit ka në rrjedhë normale 6 semestra. Shtyrja e kësaj periudhe studimi nuk mund të kalojë dyfishin e kohës normale.

Nga bashkëbisedimi me studentët e programit që është në shqyrtim, si dhe përfaqësuesit e njësisë së marrëdhënieve me studentët u informuam për procesin e familjarizimit me ofertën akademike për studentët që sapo fillojnë studimet. Shpjegimet bazike dhe përgjigja për interesimin e studentëve që sapo nisin vitin akademik ndihmon ingranimin e tyre në një kohë të shkurtër me programin. Por drejtorja e marrëdhënieve me studentët, si dhe drejtuesit e Departamentit pohuan se procesi i asistencës për studentët vijon përgjatë tre viteve që ata ndjekin programin, përmes orientimit dhe kujdestarisë, ku rol ka dhe sekretaria mësimore e cila afishon njoftime sistematike në mjediset e Kolegjit, ose dërgon virtualisht në adresat e personalizuara të studentëve. Sapo një student bën regjistrimin dhe kontratën me KUB, atij i hapet një llogari e personalizuar email-i, që është dhe një hapësirë e kontaktit dhe informimit për dinamikën e realizimit të programit, të shlyerjes së detyrimeve, të rezultateve për teste, për material që janë pjesë e procesit mësimor, literatures së detyrueshme dhe asaj fakultative etj.

Virtualisht një student në programin Bachelor ka mundësi që të hyjë në hapësirat e website-t të KUB, apo llogari të ndryshme në rrjetet sociale, për informim dhe orientim mbi ndjekjen e kurikulës, si dhe lajmërimi për evente të karakterit kërkimor dhe shkencor, social, kulturor etj.

Gjatë takimit me studentët na u demonstrua dhe aksesit që ka secili prej tyre përmes aplikimit të sistemit BIS, ku përdoruesi merrte info dhe njoftime në kohë reale mbi procesin mësimor, mbi aktivitete të ndryshme, kalendari i datave të provimeve, shlyerje ose detyrime të paplotësuara etj.

Në takimin me përfaqësuesin e zyrës së planifikimit të karrierës në KUB, si dhe bashkëbisedimin me studentët e programit në shqyrtim, u përmend dhe konsulenca që ofrohet për ta. Përshtatja me kërkesat e tregut të punës, përballimi i intervistave të pranimit, shkrimi dhe paraqitja e CV-ve, kontaktet me ish student të KUB që tashmë janë të punësuar – ishin disa nga aspektet që vlerësohen si të dobishme dhe për të cilat studentët kanë interes për ingranimin e tyre sa më të shpejtë pas përfundimit të programit.

Studentët pohuan se ata kishin akses me përfaqësues në mbledhje a takime që zhvillonte Departamenti, por dhe në rang Fakulteti apo Kolegji. Studentët kanë akses përfaqësimi dhe në aktivitetin e Senatit Akademik, apo në mbledhjet që mban Njësia e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Procesin e pranimit të studentëve KUB e planifikon disa muaj para fillimit të vitit akademik, duke aplikuar një kalendar aktivitetesh njohëse të ofertës akademike për maturantët nga zona të ndryshme të vendit. Duke rakorduar me drejtoritë rajonale arsimore realizohen kontakte me nxënës të shkollave të mesme, të cilëve ju jepet informacion bazik mbi kushtet dhe kërkesat për studimet në Kolegj, si dhe programet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.

Paralelisht me këtë angazhim në faqen zyrtare online të KUB publikohen dhe kuotat për çdo program studimi, si dhe kriteret e pranimit. Kuotat bëhen të njohura dhe për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Si një institucion jofitimprurës, KUB përshtat numrin e studentëve me infrastrukturën që disponon dhe burimet njerëzore që ka në angazhim. Informacioni në ëbsite apo organizimi i ditëve të hapura instrumente kryesore për orientimin e të rinjve që të regjistrohen në KUB, apo për të orientuar sa më shpejt me programin, kushtet dhe kërkesat ata që vendosin të ndjekin studimet këtu.

Kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë janë: mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, në masën 70% dhe intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, në masën 30%.

KUB është bazuar dhe bazohet në zbatimin e një akteve nënligjore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimin dhe regjistrimin e studentëve nga IAL-ët jo publikë.

Në bashkëbisedimin me përfaqësuesit e Zyrës së të diplomuarve dhe atij të Zhvillimit të Kurrikulave u informuam mbi përpjekjet për asistencën që u ofrohet studentëve që të jenë sa më të orientuar në tregun e

punës, për shfrytëzimin e praktikave të profesionale në institucione e kompani të ndryshme, si dhe për arritjen e sa më shumë marrëveshjeve të bashkëpunimit me subjekte publike e private, ku studentët të përfshihen me praktika të tilla.

Katër të diplomuar në programin Bsc "Shkencat e komunikimit" janë punësuar deri më tani në KUB. Ndërkohë që 91% e të diplomuarve janë punësuar dhe/ose ndjekin një cikël tjetër studimesh.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabelat 19 në Aneks)

Nga të dhënat që morëm në KUB mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve të programit të studimit Bachelor në Shkenca Komunikimi, të dhëna që janë përmbledhur dhe në tabelën 19 në Aneks të këtij raporti, grupi i ekspertëve të jashtëm konstaton se studentët e rekrutuar në gjashtë vitet e fundit në hyrje kanë mesatare pak më pak se nota 8. Nga ana e stafit akademik u pohua gjatë bashkëpunimit me ta se niveli i studentëve që regjistrohen për të ndjekur nivelin e parë të këtij programi nuk është pengesë për ecurinë dhe dinamikën e zhvillimit të kurikulës, nga niveli i njohurive që ata kanë marrë nga shkolla e mesme.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Kolegji Universitar Bedër bën transferimin e studentëve në programe të ndryshme sipas rregullores së miratuar nga ky institucion. Lejohet transferimi në vitet ndërmjetës nga IAL vendase ose të huaja, qofshin këto publike ose private, por dhe brenda për brenda programeve që vetë KUB ofron.

Në informacionin që mori grupi i ekspertëve të jashtëm si dhe në dokumentacionin që u shqyrtua për raste konkrete, dy ishin kriteret për njohjen e plotë të krediteve të grumbulluara nga një student: ngjashmëria e programit të studimit dhe koha e kryerjes së studimeve. Vendimarrjen për njohjen e plotë ose të pjesëme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, e kishte struktura mësimore që pranonte studentin.

Këshilli i Departamentit përmes një komisioni ad hoc me tre anëtarë, vlerëson dhe vendos për transferimet që kryhen në programet e KUB. Ky këshill kryen të gjitha procedurat përkatëse të ekuivalentimit të lëndëve për programet e ciklit të parë, duke i shoqëruar me një argumentim mbi kushtet e pranimit. Studentët të cilët kanë kryer procedurat e ekuivalentimit pajisen me diplomë vetëm në rast se kanë ndjekur të paktën dy semestra studime pranë Kolegjit.

Të dhëna për punësimin e studentëve Numri total i të punësuarve (në përputhje /jo në përputhje me diplomën) (Tabela 20 në Aneks):

Nga të dhënat për punësimin e studentëve që kanë përfunduar programin e studimit Bachelor në Shkencat e Komunikimit për periudhën 2013 – 2018 evidentohet se rreth 55 përqind e numrit total të të diplomuarve janë punësuar në përputhje me diplomën e fituar në KUB. Rreth 30 përqind janë të punësuar jo në përputhje me diplomën e tyre, kurse rreth 15 përqind nuk janë të punësuar. Gjatë takimit me studentët e programit, por dhe me përfaqësues të stafit akademik apo të Zyrës së Kurikalave, përqindja e atyre që janë punësuar jo në përputhje me diplomën u konsiderua e lartë. Por ata shprehën mendimin se ndjekja e ciklit të dytë të programit do t'i bënte ata më konkurrentë në treg me shanse më shumë për punësimin brenda profilit ku diplomohen. Një faktor është dhe fenomeni i punësimit të parakohshëm të studentëve, pa prituri mbarimin e studimeve, gjë që i vendos ata në zgjidhje punësimi jashtë profilit, status që e mbajnë edhe pas diplomimit si një mbështetje ekonomike që ju nevojitet sidomos për mundësimin e ndjekjes së studimeve në ciklin e dytë Master Shkencor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet	Sa i takon procedurave për pranimin e studentëve në ciklin e parë

në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.

Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.

të studimeve, përfshirë këtu dhe ata të Shkencave të Komunikimit, baza ligjore ka qenë ligji nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" deri në vitin 2015. Më pas janë zbatuar kërkesat e ligjit të miratuar nga Kuvendi, nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë janë: mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, në masën 70% dhe intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, në masën 30%. Për ata studentë që kanë me aftësi të veçanta, talente dhe që kanë fituar çmime, Kolegji ofron deri në bursë të plotë studimi.

Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;

Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lende, në përfundim të semestrit;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;

Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Nga bashkëbisedimi me studentët e programit që është në shqyrtim, si dhe përfaqësuesit e njësisë së marrëdhënieve me studentët u informuam për procesin e familjarizimit me ofertën akademike për studentët që sapo fillojnë studimet. Shpjegimet bazike dhe përgjigja për interesimin e studentëve që sapo nisin vitin akademik ndihmon ingranimin e tyre në një kohë të shkurtër me programin. Por drejtorja e marrëdhënieve me studentët, si dhe drejtuesit e Departamentit pohuan se procesi i asistencës për studentët vijon përgjatë tre viteve që ata ndjekin programin, përmes orientimit dhe kujdestarisë, ku rol ka dhe sekretaria mësimore e cila afishon njoftime sistematike në mjediset e Kolegjit, ose dërgon virtualisht në adresat e personalizuara të studentëve. Sapo një student bën regjistrimin dhe kontratën me KUB, atij i hapet një llogari e personalizuar email-i, që është dhe një hapësirë e kontaktit dhe informimit për dinamikën e realizimit të programit, të shlyerjes së detyrimeve, të rezultateve për teste, për material që janë pjesë e procesit mësimor, literatures së detyrueshme dhe asaj fakultative etj.

Virtualisht një student në programin Bachelor ka mundësi që të hyjë në hapësirat e ëbsite-t të KUB, apo llogari të ndryshme në rrjetet sociale, për informim dhe orientim mbi ndjekjen e kurikulës, si dhe lajmërimi për evente të karakterit kërkimor dhe shkencor, social, kulturor etj.

Gjatë takimit me studentët na u demonstrua dhe aksesi që ka secili prej tyre përmes aplikimit të sistemit BIS, ku përdoruesi merrte info dhe njoftime në kohë reale mbi procesin mësimor, mbi aktivitete të ndryshme, kalendari i datave të provimeve, shlyerje ose detyrime të paplotësuara etj.

Në takimin me studentët e programit në shqyrtim, si dhe drejtuesit e Departamentit u informuam se zhvilloheshin në mbyllje të çdo semestri vlerësime nga studentët përmes pyetësorëve standard. Anketat ishin me target të ndryshëm: vlerësim i studentëve për personelin akademik, vetëvlerësimin e personelit, vlerësimin e eprorëve për vartësit etj. Studentët u shprehën se pyetësorët që ju viheshin në dispozicion virtualisht përmes sistemit BIS, ishin

konfidencialë dhe të qartë në formulimin e pyetjeve. Set-i i pyetjeve përfshinte aspekte konkrete cilësore dhe sasiore të angazhimit të personelit akademik.

Drejtimesit e Fakultetit dhe të Departamentit na pohuan se rezultatet e mendimeve të studentëve ju shpërndareshin individualisht pedagogëve, dhe kjo ishte një bazë shumë e rëndësishme për ecurinë e tyre, për efektivitetin e punës së tyre në realizimin e programit.

Në takimin me përfaqësuesin e zyrës së planifikimit të karrierës në KUB, si dhe bashkëbisedimin me studentët e programit në shqyrtim, u përmend dhe konsulenca që ofrohet për ta. Përshtatja me kërkesat e tregut të punës, përballimi i intervistave të pranimit, shkrimi dhe paraqitja e CV-ve, kontaktet me ish student të KUB që tashmë janë të punësuar – ishin disa nga aspektet që vlerësohen si të dobishme dhe për të cilat studentët kanë interes për ingranimin e tyre sa më të shpejtë pas përfundimit të programit.

Departamenti ku përfshihet program që është në shqyrtim, ka realizuar cikël leksionesh, të njohura si “Studenti dhe profesioni”, “Seminaret MarCOM” etj., përmes të cilave studentët janë informuar mbi mundësitë e punësimit në tregun e punës.

Studentët pohuan se ata kishin akses me përfaqësues në mbledhje a takime që zhvillonte Departamenti, por dhe në rang Fakulteti apo Kolegji. Studentët kanë akses përfaqësues dhe në aktivitetin e Senatit Akademik, apo në mbledhjet që mban Njësia e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë.

Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

Grupi i ekspertëve të jashtëm në takimin me përfaqësuesin e Zyrës së të Diplomuarëve, e cila funksionon në varësi të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët u informua hollësisht me angazhimin e zyrës, lidhjeve me të diplomuarit, ecurinë e punësimit të tyre, brenda ose jashtë profilit ku kanë ndjekur studimet në nivelin e parë. Nga ana tjetër Sekretaria Mësimore në data base e saj përfshin dhe të dhënat vit pas viti për numrin e studentëve të diplomuar.

Në takimin që u zhvillua në Sekretarinë Mësimore të Kolegjit u informuam por dhe na treguan dokumentacion të depozituar me të dhëna që kishin mbi numrin e studentëve në ciklin e parë, ku përfshiheshin si raste të finalizimit të ciklit të plotë, ashtu dhe raste të ndërprerjeve për shkaqe të ndryshme a largime. Dekanatit u jepeshin sistematikisht nga Sekretaria Mësimore të dhëna statistikore mbi ecurinë sipas programeve të studimit

Në dokumentacionin e Sekretarisë Mësimore përfshiheshin të plotë ecuritë e studentëve në programin që është në shqyrtim, nga pranimi në vitin e parë dhe deri në diplomimin e tyre. Bazuar në rregulloren që kishte miratuar Kolegji këto të dhëna arkivoheshin.

Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor,

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Zyra e Planifikimit të Karrierës në Kolegj ka ndërtuar një strukturë kapilare, ku pranë secilit departament ka ngritur Bord Këshillimit të Karrierës. Bordi ka shtatë anëtarë, të cilët janë urë komunikimi dhe ndërmjetësimi mes studentëve dhe tregut të punës.

Në takimin me përfaqësuesin e Zyrës për planifikimin e karrierës u informuam dhe për angazhimin që ka kjo njësi për procesin realizimit të praktikave profesionale nga ana e studentëve.

Departamenti ka formate aktivitete, të cilat u vijnë në ndihmë studentëve për lidhje me tregun e punës, si realizimin e ciklit të leksioneve të hapura "Studenti dhe profesioni", "Seminaret MarCOM", etj.

Në bashkëbisedimin me përfaqësuesit e Zyrës së të diplomuarve dhe atij të Zhvillimit të Kurrikulave u informuam mbi përpjekjet për asistencën që u ofrohet studentëve që të jenë sa më të orientuar në tregun e punës, për shfrytëzimin e praktikave të profesionale në institucione e kompani të ndryshme, si dhe për arritjen e sa më shumë marrëveshjeve të bashkëpunimit me subjekte publike e private, ku studentët të përfshihen me praktika të tilla.

Përmes Zyrës për Planifikimin e Karrierës, Departamenti ka krijuar një rrjet institucionesh për bashkëpunim, brenda dhe jashtë vendit. Kjo ka lehtësuar përzgjedhjen dhe ka rritur efektivitetin e vendit se ku do të kryet praktika profesionale praktikën profesionale, që ajo të jetë e orientuar në përputhje me kurikulën e programit.

Praktika profesionale është pjesë e korpusit të lëndëve në programin mësimor që është në shqyrtim. Synimi në Departament është që me realizimin e saj jo vetëm të konkretizohet pjesa teorike e programit, por dhe që mundësisht praktika të jetë një premisë si vend pune në të ardhmen për studentin.

Konkluzionet e vlerësimit:

KUB për pranimin e studentëve në ciklin e parë të studimeve ka ndjekur dhe ndjek kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Procesi i familjarizimit me ofertën akademike shpjegimet bazike dhe përgjigjet për interesimin e studentëve që sapo nisin që pas regjistrimit të tij në program dhe asistenca vijon përgjatë tre viteve, përmes orientimit dhe kujdestarisë. Sapo një student bën regjistrimin dhe nënshkruan kontratën me KUB, atij i hapet një llogari e personalizuar email-i, që është dhe një hapësirë e kontaktit dhe informimit për dinamikën e realizimit të programit, të shlyerjes së detyrimeve, të rezultateve për teste, për material që janë pjesë e procesit mësimor, literaturës së detyrueshme dhe asaj fakultative, anketave dhe pyetësorëve vlerësues etj.

Kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë janë: mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, në masën 70% dhe intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, në masën 30%.

KUB është bazuar dhe bazohet në zbatimin e një akteve nënligjore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimin dhe regjistrimin e studentëve nga IAL-ët jo publikë.

Për ata studentë që kanë me aftësi të veçanta, talente dhe që kanë fituar çmime, Kolegji ofron deri në bursë të plotë studimi.

Përmes zyrës së planifikimit të karrierës atyre u jepej konsulencë mbi përshtatjen me kërkesat e tregut të punës, përballimi i intervistave të pranimit, shkrimi dhe paraqitja e CV-ve, kontaktet me ish student të KUB që tashmë janë të punësuar – ishin disa nga aspektet që vlerësohen si të dobishme dhe për të cilat studentët kanë interes për inçanimin e tyre sa më të shpejtë pas përfundimit të programit.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e situara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënive me Publikun është pjesë e strukturës organizative të Fakultetit të Shkencave Humane në KUB. Departamenti është angazhuar në proces të kërkimit shkencor si nëpërmjet pedagogëve në përfaqeset e tyre personale për rritje dhe kualifikim, ashtu edhe me anë të aktiviteteve (konferenca, ëorkshope, seminare) të realizuara në rang fakulteti dhe kolegji universitar. Në fillim të çdo vitit akademik, Departamenti merr nga secili pedagog një plan të aktivitetit të tij dhe publikimeve të planifikuara. Bazuar në rregulloren e KUB (rregullore të kërkimit shkencor BU-DIR-004-AL e publikuar në 01.10.2012) pjesëmarrja në të tilla aktivitete është e përfshirë edhe në ngarkesën e punës së pedagogëve.

Në rang Kolegji Universitar është e ngritur Zyra e Kërkimit Shkencor e cila ka rol kordinimi të aktiviteteve me njësitë e tjera, departamentet dhe studentët. Kolegji KUB stimulon kërkimin shkencor edhe me mbështetje financiare të pedagogëve. Çdo fillim viti akademik, një shifër deri në Euro 700 është në dispozicion të pedagogëve për pjesëmarrjen e tyre në veprimtari kërkimore, konferenca ndërkombëtare dhe publikime. Pedagogët aplikojnë për këtë mbështetje financiare në bazë të kriterëve të përcaktuara në “Praktika e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca” dhe “udhëzimin mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor”.

Kolegji Universitar BEDER ka një program afatmesëm zhvillimi pjesë e të cilit është edhe rritja e pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe publikimeve nga stafi akademik.

KUB, pas përfundimit të afatit 5 vjeçar nga akreditimi i parë ka filluar edhe programin e mobiliteteve të studnetëve. Gjatë vitit të kaluar akademik kanë qenë dy studentë që morën pjesë në shkëmbime duke shkruar në një Universitetet në Norvegji dhe Turqi Gjithashtu një student nga një Universitet i Turqisë bëri një semestër në kuadër të mbrojtjes së tezës së tij pranë Kolegjit Universitar BEDER.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabelat 21, 22 dhe 23.1 dhe 23.2 në Aneks)

Nga dosja e vlerësimit të brendshëm KUB pasqyron mjaft aktivitete të organizuara si konferenca dhe ëorkshope me tematika të ndryshme, sidomos të lidhura me komunikimin. Kjo është një vlerë e shtuar e këtij Departamenti dhe e punës që ai bën me studentët dhe përgatitjes së tyre si teorike ashtu edhe më njohuritë më të fundit nga zhvillimet e tregut mediatik.

Në mënyrë të përmbledhur konferencat dhe ëorkshopet renditen më poshtë.

Konferenca studentore dhe workshope:

1. Konferenca II Studentore: “Komunikimi, media dhe përgjegjësia sociale”, 12 Mars 2014;

2. Kultura dhe arsimit si ura komunikimi midis Shqipërisë dhe Francës, 27 Mars 2014;
3. Workshop Rajonal me temë "Gjuha mediatike e medie shqipfolëse", 3 Maj 2014;
4. Konferenca e III studentore në komunikim, 14 Maj 2015;
5. "Domosdoshmëria e pjesëmarrjes së të rinjve në zgjedhje", 26 Maj 2015;
6. Konferenca e Katërt Studentore në Shkenca Komunikimi, 13 qershor 2018;
7. Të Miturit në Objektivin e Medias, 15 Nëntor 2017;
8. Marrëdhënia e Medias me Audiencat në Epokën Digjitale - Departamenti i Shkencave të Komunikimit në KUB - workshop "Marrëdhënia e Medias me Audiencat në Epokën Digjitale", 7 Janar 2018;
9. Fake News, Problem i Medias apo i Demokracisë? 16 Maj 2018

Konferenca Ndërkombëtare:

1. **ICCMS 2015** - Konferenca Ndërkombëtare mbi studimet në media dhe komunikim me temë: "Industria e medias, trendet, dinamika dhe sfidat", **26-27 Mars 2015**
2. **Konferencë Ndërkombëtare në Studimet e Medias dhe Komunikimit** - Departamenti i Shkencave të Komunikimit në KUB në bashkëpunim me Autoritetin e Medie Audiovizive, Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në UT dhe Kolegjin AAB në Prishtinë, **15 Dhjetor 2016**

Siç shihet edhe nga tematika e konferencave dhe frekuenca e zhvillimit të tyre, Departamenti është përpjekur të përfaqësojë në konferenca tematikat e ditës, zhvillimet aktuale të medias duke ofruar përfaqësim të teoritë dhe praktike. Tematikat e gjuhës së folur, pjesëmarrja në zgjedhje dhe më pas transformimet që pëson media në epokën digjitale kanë qenë tema të rëndësishme në periudhat kohore në të cilat janë zhvilluar. Po kështu edhe tematika e lajmit të vërtetë dhe lajmit të rremë zhvilluar në 2018 është një tematikë mjaft aktuale edhe në këtë periudhë. Frekuenca thuhet se vjetore e këtyre aktiviteteve i jep një mundësi studentëve në të gjitha etapat e shkollimit të tyre, si në programin e ciklit të parë ashtu edhe në atë të ciklit të dytë të jetë pjesëmarrës në to.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Kolegji Universitar BEDER për realizimin e misionit dhe objektivave të tij, ka bashkëpunuar me si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Bashkëpunimi është i sanksionuar edhe si pjesë përbërëse e strategjinë afatgjatë të zhvillimit të institucionit, "Plani Strategjik 2018-2023", miratuar me Vendimin Nr. 2 të Senatit Akademik të KUB datë 21.03.2018.

KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore të vendit dhe të huaja për të realizuar mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve, organizimin e përbashkët të konferencave dhe projekteve, si edhe trajnimet profesionale dhe praktikant studentore. Në shifër janë rreth 60 marrëveshje bashkëpunimi me universitete, institucione të pushtetit lokal, organizma publikë dhe privatë.

Sikurse përshkruhet edhe në pikën 10 Kërkimi Shkencor të këtij raporti, Kolegji Universitar BEDER ndër vite ka organizuar dhjetëra konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit, ku vlen të përmenden bashkëpunimet me Institutin Shqiptar të Medias si edhe

Autoritetin e Mediave Audiovizive. Nga këto bashkëpunime KUB merr parasysh sugjerimet edhe të studimeve të lidhura me tregun e punës të organizuara nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit.

Gjithashtu KUB ka patur lektorë të huaj të ftuar nga vende të ndryshme si Franca, Italia, Sllovenia, Turqia, SHBA, Anglia, Gjermania, Spanja, Kosova, Maqedonia, Kina. Një pjesë e profesorëve të ftuar kanë ardhur në kuadër të marrëveshje të bashkëpunimit me universitete të ndryshme.

KUB synon të thellojë më tej bashkëpunimin dhe me projekte ndërkombëtare si TEMPUS dhe ERASMUS + për t'i shërbyer më tej edhe mobilitetit të studentëve dhe pedagoqeve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabelat 24 në Aneks)

Departamenti i Shkencave të Komunikimit si pjesë e KUB është përfshirë në projektet e fituara dhe të realizuara nga institucioni. Publikimet e stafit të Departamentit datojnë që prej vitit 2014. Një pjesë e mirë e tyre janë të lidhura me konferencat ndërkombëtare që ka zhvilluar KUB. Kështu përgjatë viteve 2014-2018 janë respektivisht 12, 29, 16, 12 dhe 2 publikime dhe projekte të personelit të departamentit.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabelat 25 në Aneks)

Departamenti i Shkencave të Komunikimit si pjesë e KUB ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me mjaft universitete dhe aktorë në tregun e punës. Sikurse shihet edhe nga raportet e vlerësimit të brendshëm KUB ka marrëveshje me 37 universitete dhe kolegje universitare. Gjeografia e shpërndarjes së këtyre universiteteve është si nga Shqipëria (universitete publike dhe private) Turqia, Itali, SHBA, Slloveni, Kinë, etj. Synimi i këtij bashkëpunimi lidhet si me organizmin e përbashkët të projekteve dhe aktiviteteve ashtu edhe për shkëmbimin e stafit dhe të studentëve.

Gjithashtu ka krijuar lidhje me organizata profesionale si AMA, Unioni i Gazetarëve të Shqipërisë, KMSH, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Bashkia e Tiranës dhe Prefektura e Tiranës, etj.

Një komponentë shumë e rëndësishme në realizimin e programit mësimor dhe praktikave studentore është edhe lidhja me komunitetin e biznesit. Janë rreth 50 organizma mediatikë si media apo PR me të cilat Departamenti i Shkencave të Komunikimit bashkëpunon në realizimin e planeve të tij mësimore.

Të gjitha këto bëjnë të mundur plotësimin e standarteve të bashkëpunimit nga institucioni.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Shkëmbimi i informacionit brenda KUB realizohet nëpërmjet sistemeve të teknologjisë së Informacionit dhe faqes zyrtare të komunikimit.
Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	Departamenti i Shkencave të Komunikimit zhvillon mbledhje javore për të diskutuar ecurinë e programeve mësimore në mënyrë që i gjithë stafi i departamentit të njihet me problematikat dhe arritjet e kolegëve dhe stafit në departament duke krijuar mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave dhe

bashkëpunimit të brendshëm.
KUB ka një bazë të fortë institucionale të organizuar dhe rregullore të detajuara të cilat mundësojnë marrjen e informacionit dhe përgjegjësi të përkatëse, analizën e vazhdueshme të punës së tyre dhe bashkëpunimin.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkëpunim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

KUB ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit si edhe me aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Një rëndësi e veçantë i kushtohet praktikave profesionale organizimi i të cilave mundësohet edhe nëpërmjet marrëveshjeve të ndryshme të lidhura nga KUB. Kjo është shumë e dukshme për studentët e shkencave të komunikimit të cilët i zhvillojnë këto praktike edhe gjatë periudhës së verës.

Zyra e Projekteve dhe Zyra e Marrëdhënieve me jashtë janë një ndër lidhës i këtij komunikimi midis stafit akademik, dhe tregut dhe mjedisit profesional jashtë institucionit.

KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta kërkimore dhe për trajnime profesionale. Konferencat vjetore janë kthyer në një bazë të mirë të shkëmbimit të eksperiencave me pedagogë vendas dhe të huaj.

Programi Bachelor në Shkenca Komunikimi ka zhvilluar seminarin MarCOM, "Studenti dhe Profesion" dhe trajnime të tjera profesionale. Gjithashtu Departamenti organizon ëorkshopen e ndryshme në bashkëpunim me punëdhënësit të ndryshëm me qëllim formimin e studentëve në përputhje me kërkesat aktuale të tregut të punës.

KUB nuk ka marrëveshje kontraktuale me të tretë për realizimin e programeve të studimit, pasi këto realizohen brenda institucionit.

Konkluzionet e vlerësimit:

Në raport me marrëdhëniet dhe bashkëpunim kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me jashtë standardet janë përmbushur. KUB bën përpjekje për zhvillimin më tej të aspektit bashkëpunues kombëtar dhe ndërkombëtar të programeve të tij të studimit, përmes marrëveshjeve të suksesshme me institucione të tjera, brenda e jashtë vendit.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Grupi shprehet për plotësimin e rekomandimeve, si më poshtë:

Rekomandimet në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 469, datë 03.05.2013	Mendimi i ekspertëve për plotësimin/ mosplotësimin e rekomandimeve
a) Të qenurit një institucion i ri, sjell mungesën e përvojës dhe të traditës të cilat i japin departamentit dhe programit mësimor një qëndrueshmëri dhe besueshmëri;	Rekomandim i plotësuar
b) Të rritet numri i personelit akademik efektiv;	Rekomandim i plotësuar
c) Të përshtatet fusha e studimit të personelit akademik me disiplinën përkatëse;	Rekomandim i plotësuar
d) Të përmirësohet programi i disiplinës Gjuhë Shqipe 1 dhe 2;	Rekomandim i plotësuar
e) Të sigurohen tekste bazë në disa disiplina;	Rekomandim i plotësuar
f) Të rritet numri i titujve dhe botimeve bashkëkohore në bibliotekën e Institucionit;	Rekomandim i plotësuar
g) Të realizohet një raport financiar për këtë program studimi.	Rekomandim i plotësuar

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES -MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Pjesëmarrje aktive e pedagogëve dhe studentëve në konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare
- 2) Biblioteke online dhe shume tituj – libra për komunikimin nga Ambasada e SHBA në Tiranë. Infrastruktura e klasa auditore, smart bord
- 3) Team spirit të studenteve, aktive, të punësuar, që zhvillojnë internship (jashtë krediteve që u duhen për praktikë. Klubet studentore dhe aktivitetet ekstrakurikulare, pjesëmarrja e tyre në nisma sociale, auditorët e hapur me të ftuar të shumtë
- 4) Muzeu i medias interesant, pjesë për edukimin e zhvillimeve historike në media
- 5) Qëndrueshmëria e stafit akademik të brendshëm.
- 6) Pedagogët e jashtëm, me kohë të pjesshme PAK janë nga emrat e njohur në fushën e medias në vend. Kjo sjell një benefit për studentët dhe Departamentin duke sjellë tregun real të medias në auditor.
- 7) Media online www.objektiv.al një mundësi më shumë për të bërë praktikë dhe për studentët për të patur njohuri nga tregu mediatik.
- 8) Mbështetja financiare e pedagogeve për pjesëmarrje në konferenca.
- 9) Grupe të vogla studentësh, pra jo grupe masive, gjë që sjell mundësinë për punë më specifike dhe të detajuar me studentët.
- 10) Bashkëpunimi me mediat dhe organizma të ndryshëm për praktika dhe kërkimin shkencor të studentëve.

- 11) Sistemi i brendshëm i komunikimit BIS që lehtëson procesin e mësimdhënies dhe krijon interaktivitet midis studentëve dhe stafit.
- 12) Këshillimi i karrierës së studentëve dhe i përzgjedhjes së lëndëve nëpërmjet Këshilltarëve Akademikë dhe Zyrës së Karrierës.

b. Pika për përmirësim të mëtejshëm:

- 1) Nevoja për forcimin e komponentit të pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare universitare dhe futja në network universitare.
- 2) Mobilitet i vogël i studentëve me universitetet jashtë vendit. Nevoja për të rritur këtë mobilitet edhe tek pedagogët.
- 3) Nevoja për më shumë literaturë në gjuhën shqipe.
- 4) Rritja e hapësirave sociale për studentët për shoqërim të tyre gjatë dhe pas orareve zyrtare të mësimit.

c. Mundësitë:

- 1) Procesi i integritit evropian krijon mundësi për studentet exchange, projekte bashkëpunimi dhe projekte të tjera në kuadër të ERASMUS, etj.
- 2) Progresi teknologjik krijon mundësi për degëzime të reja të gazetarisë/PR që e lidhin atë me shumë me profesione të tjera.
- 3) Kalimi përfundimtar në transmetime televizive dixhitale, do të krijojë nevojën për projekte kërkimore, për të parë zhvillimin e audiencave, dhe kjo mund të jetë një mundësi që Departamenti të përfshihet më shumë në projekte kërkimore shkencore.
- 4) Rritja e mundësive për punësim të studentëve në profesione të reja/institucione të reja mediatike që po hapen si pasojë e zhvillimeve teknologjike.

d. Pengesat:

- 1) Gazetaria konsiderohet një profesion që zbehet gradualisht, po zvogëlohet kërkesa për këtë profesion në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar.
- 2) Formatimi ndryshe i profesionit dhe zhvillimet teknologjike kanë rritur përfshirjen e gazetarisë qytetare me anën e portaleve online.
- 3) Rënia besueshmërisë tek gazetaria për arsye të lajmeve të paverifikuara që përhapen herë pas here në vend, kryesisht nga portalet online
- 4) Informaliteti i tregut të punës në vend, e shprehur kjo edhe në tregun e medias.

Rekomandime:

- Departamenti dhe KUB në tërësi duhet të forcojë komponenten e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, për kërkimin shkencor si edhe projektet e BE. Kjo është sidomos e nevojshme në ato të projekteve universitare dhe shkëmbimit të studentëve dhe pedagogëve.

- *Departamenti nevojitet ta vijojë punën për plotësimin me literaturë në gjuhën shqipe, pavarësisht se ka një literaturë të gjerë në gjuhën angleze. Plotësimi me literaturë shqipe është një proces i vazhdueshëm dhe i tillë për të gjitha institucionet e arsimit të lartë.*
- *KUB duhet të synojë rritjen e hapësirave sociale për studentët. Kjo i shërben edhe më mirë shoqërizimit të tyre pas orareve zyrtare të mësimit duke krijuar frymën e grupit dhe të bashkëpunimit të nevojshëm edhe për vazhdimësinë e mëtejshme në raportet e punës.*

SWOT ANALYSIS – Bachelor in Communication Sciences

Comprehensive analysis basen on the SWOT method (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats)

STRENGTHS:

1. Active participation of lectors and students at national and international conferences.
2. Books' library and online library research access with titles' updates (Jstore online and EBSCO system provides another opportunity for recent literature).
3. There is a encouraged team spirit among the students. They are active, most of them are employed and also have internship period (out of their credit system needed for practice). They are very active in the student's clubs and other extracurricular activities, their participation in social initiatives, open auditors with numerous guests.
4. Enriched media museum, as an important tool for students' education with the country historical media developments.
5. Stability of academic staff, specially refereeing those with full time contract.
6. Part-time lectors are among the well-known personalities in the media field in the country. This is to the benefit of the students and the Department at BEDER, especially by bringing the real media market to auditors.
7. Online media www.objektiv.al is another great opportunity for students to practice and have knowledge how the real media works.
8. Financial support of lectors/pedagogues to participate in conferences.
9. Classes are made of small groups of students, (not overcrowded classes), which gives opportunity for a more specific and detailed work with the students.
10. Cooperation with media organizations and other institution for the practice and research of students.
11. The BIS, internal communication system facilitates the process of teaching and learning, as well as creates interactivity between students and staff.
12. There is a career consulting office as well as Academic Counselor which advice the students in selecting of the subjects and ways to advance in profession.

POINTS FOR FURTHER IMPROVEMENT:

1. Further strengthening of the participation in university projects abroad is needed and active participation in the universities network.
2. Students' mobility with the foreign universities needs to be increased. There is also a need to increase the mobility among the lectors/ teachers.

3. There is an increased need for further literature in the Albanian language.
4. There is a need to increase the entertainment and socialization area to the benefit of students, during and after the class hours

OPPORTUNITIES:

1. The EU integration process will create greater opportunities for students exchange, cooperation projects and others in the framework of ERASMUS, etc.
2. Technology progress creates opportunities for new forms of journalism and PR, creating better connection to other professions as well.
3. The final transition to digital TV broadcasting creates the need for research projects to look at the development of audiences. This may rise an opportunity for the Department to be involved in scientific research projects.
4. Increase students employment opportunities in the new upcoming professions/new media institutions that are emerging as a result of technological developments.

THREATS:

1. Journalism is considered a profession that is gradually fading out and the demand for this profession is diminishing at national and international level.
2. The journalist profession is being formatted and shaped differently, mainly due to technology developments and the increased involvement of civic journalism through online portals.
3. Decrease of trust in journalism due some publication of unverified news items that occasionally spread in the country, mostly from online portals. This is related to lowering the number of students wishing to study in this profession.
4. Informality of the labor market in the country, reflected also in the media market.

Recommendations:

1. *The Department and KUB as an institution need to strengthen the component of participation in international research projects, as well as EU projects. This is especially important for participation in university and students/professors exchange projects.*
2. *The Department needs to continue working on completing literature in Albanian language, despite having a large literature in English. Filling with Albanian literature is a continuous process for all institutions of higher education.*
3. *KUB should aim to increase social areas for students. This serves to a better socialization of them outside the class official hours, thus creating a team spirit and the necessary collaboration so much in demand in their future working environment.*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Dr. Diana Kalaja

Dr. Arben Muka